



Co-funded by the  
Erasmus+ Programme  
of the European Union

# DORACAK I MODULEVE TË MËSIMDHËNIES

*\* Ky Projekt është financuar me mbështetjen e Komisionit Evropian. Ky Doracak i moduleve të mësimdhënies pasqyron vetëm pikëpamjet e anëtarëve të Projektit, dhe Komisioni nuk mund të mbahet përgjegjës për çfarëdo përdorimi që mund të bëhet nga informacionet e përfshira në të.*

*Shkurt, 2018*

## **Përmbajtja**

1. Hyrje.....	3
1. Konceptet kyçe në rehabilitimin social.....	4
2. Kompetenca e mësimdhënësit - Përkufizimi i shkathtësive .....	8
3. Pedagogjia bashkëkohore.....	11
4. Bashkë-krijimi.....	13
5. Planifikimi i lëndës .....	17
6. Shtojcat .....	19
I. Të nxënit e bazuar në probleme .....	19
II. Përgatitja e një posteri është detyrë e të nxënit të bazuar në projekt.....	26
III. Bashkë-krijimi .....	29
IV. Nxënia e bazuar në simulime.....	33
V. Nxënia e bazuar në hulumtim.....	39
VI. Lehtësimi i të nxënit (mbikëqyrja dhe trajnimi).....	40
7. Referencat.....	47

# 1. Hyrje

Ky Doracak paraqet një përgjigje ndaj mungesës së kompetencave të përcaktuara të cilat janë të nevojshme për mësimdhënien e rehabilitimit social në nivel terciar dhe profesional të arsimit në Kosovë. Në të vërtetë, ai ka për qëllim të përmirësojë kompetencat në planifikimin e lëndëve dhe në krijimin e materialeve relevante të studimit, si dhe të lidhë strategjitë formative, jo- formative dhe informuese të të nxënit. Ky Doracak do të plotësojë rezultatet tjera të Projektit siç janë lëndët e sapo krijuara të Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional.

Përmbajtja e këtij dokumenti është hartuar nga rrethi studiues i Kosovës, i përbërë nga mësimdhënës, staf menaxhues dhe profesionistë shëndetësor të partnerëve të projektit në Kosovë (Kolegji Heimerer, Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”, Ministria e Shkencës, Arsimit dhe Teknologjisë) dhe akterë tjerë të rëndësishëm nga Kosova. Partnerët evropianë të Projektit: universitetet e përmendura që kanë ofruar përkrahje të vazhdueshme virtuale dhe ballë për ballë (vizita mësimore) për rrethin përkatës studiues.

Procesi i zhvillimit të këtij dokumenti u realizua në bazë të teorisë bashkë-konstruktiviste dhe metodës bashkëpunuese të punës. Kjo metodë është argumentuar si e përshtatshme për zhvillimin e kompetencave të rehabilitimit social, sidomos kur rehabilitimi bazohet në bashkëpunimin ndërmjet klientëve dhe profesionistëve në kontekste komplekse.

Grupet kryesore të synuara janë mësimdhënësit universitarë dhe mbikëqyrësit klinikë që veprojnë në fushën e rehabilitimit social.

# 1. Konceptet kyçe në rehabilitimin social

*Dianna Ulrich, Arben Boshnjaku*

## **Rehabilitimi social**

Rehabilitimi social përkufizohet si një përmirësim i kushteve dhe pasurim i shkathtësive personale. Ai përfshin shërbimet e dedikuara për të gjithë individët me aftësi të kufizuara dhe paaftësi të pjesshme ose të plotë për punë, të cilëve u nevojitet ndihmë për t'u marrë me problemet e jetës së përditshme që rezultojnë nga aftësia e kufizuar ose nevojat e veçanta (Mountain, 2001).

Krahasuar me rehabilitimin fizioterapeutik ose ergoterapeutik, të cilat mendohet të jenë thelbësore për shërim dhe rehabilitim optimal ku rezultati kryesor fokusohet kryesisht në aspektet fizike, (De Lee and Prez 1994, Harries et al 1994, Sallis and Massimo, 1997) si dhe u drejtohet individëve që kanë moshën për të punuar, me aftësi të zvogëluar për punë, rehabilitimi social merret drejtpërdrejt me aspektin social të shëndetit, lëndimeve dhe sëmundjeve. Qëllimi kryesor i rehabilitimit social është përmirësimi i shkathtësive sociale dhe përballja me jetën e përditshme. Qëllimi është që “njerëzit me dhe pa aftësi të kufizuara të jetojnë në një mënyrë të vendosur nga vetë ata dhe të jetojnë së bashku në të gjitha fushat e jetës” (BAS, 2015). Kjo arrihet duke ndihmuar dhe arsimuar njerëzit në nevojë për të rivendosur pavarësinë e tyre në aktivitetet shtëpiake, vetë-kujdesin personal, kujdesin për financat, sigurinë dhe socializimin në komunitetin e tyre (siç është vetë-kujdesi personal, detyrat e brendshme, menaxhimi i financave, shopping (blerjet), socializimi, mobiliteti brenda komunitetit të tyre, etj.).

Në përgjithësi, rehabilitimi social synon të përmirësojë një qasje shumë-disiplinare, zhvillimin bashkëpunues, ndërveprimin midis individit dhe shoqërisë, si dhe të nxisë individët për të qenë aktivë në rehabilitimin e tyre. Rehabilitimi social lidhet fuqimisht me Cilësinë e Jetës (CeJ). Koncepti i CeJ-së së përgjithshme, tradicionalisht, ka përfshirë një sërë fushash të dalluara dhe tregues të rëndësishëm, të cilëve shumica e autorëve u referohen si tregues ekonomik, social ose subjektiv (Gigantesco & Giuliani, 2011).

## **Të mësuarit gjatë gjithë jetës**

Profesionisti i sotëm shëndetësor duhet të jetë vazhdimisht në hap me arritjet dhe zbulimet bashkëkohore mjekësore. Profesionisti i sotëm shëndetësor duhet gjithmonë të ketë parasysh se individët kanë qasje të pakufizuar në njohuritë bashkëkohore shkencore përmes internetit. Pacientët e tanishëm nuk janë të njëjtë me ata të së kaluarës; pacienti aktual ka një armë shumë të fuqishme në duart e tij dhe është në gjende që ndonjëherë ta përcaktojë vetë diagnozën. Për aq sa ka mbështetur interneti zhvillimin e vazhdueshëm të shkathtësive profesionale dhe njohurive të profesionistëve shëndetësor, ai gjithashtu edhe ka rritur njohuritë mbi shëndetin brenda popullatës së përgjithshme. Mund të thuhet pa dyshim se periudha në të cilën po jetojmë ofron mundësi të pafundme për qasje në njohuri të pakufishme.

Rritja aktuale e njohurive bio-mjekësore, avancimet teknologjike si dhe zhvillimet e politikave sociale dhe shëndetësore janë duke ndikuar në vazhdimësi, në edukimin mjekësor (Drake et al., 2009; Romãozinho, 1995). Kjo reflektohet drejtpërsëdrejti në reformat e kurrikulës mjekësore në të cilat programi tradicional kurrikular i bazuar në disiplinë është

duke u zëvendësuar nga sisteme integruese të përziera dhe programe për shumë disiplina (të ashtuquajtura kurrikula spirale) (Irby et al., 2010; Drake 2014; Coelho & Moles, 2015).

Fushat e reja të njohurive mund të plotësojnë jo vetëm boshllëqet ekzistuese në kurrikulën bërthamë por gjithashtu të ofrojnë aftësi jo-kognitive për studentët, thelbësore për praktikën klinike (Martins e Silva, 2013). Këto fusha të reja të njohurive nuk pritet të integrohen vetëm në kurrikulat e studimeve universitare, por edhe në studimet post-diplomike dhe të mëtejshme.

Të mësuarit gjatë gjithë jetës do të thotë që të mësuarit duhet të zhvillohet në të gjitha fazat e ciklit jetësor (nga lindja deri në vdekje) dhe, sipas këndvështrimeve të fundit, duhet të jetë gjithë- jetësor pra të jetë pjesë e të gjitha konteksteve të jetës nga shkolla në vendin e punës, në shtëpi dhe në komunitet. Prandaj, shoqëria që mëson është vizioni i një shoqërie në të cilën njihen mundësitë për mësim për çdo person kudo që ai/ajo është dhe pa marrë parasysh moshën e tij/saj (Green, 2002).

Përveç kësaj, të mësuarit gjatë gjithë jetës ka të bëjë me ofrimin e shanseve të dyta për të përditësuar aftësitë themelore si dhe me ofrimin e mundësive të të mësuarit në nivele më të avancuara. E gjithë kjo do të thotë që sistemet formale të ofrimit të arsimit duhet të bëhen shumë më të hapura dhe fleksibile, në mënyrë që mundësitë e tilla të përshtaten siç duhet me nevojat e studentët ose në fakt të studentët potencial (Komisioni Evropian, 2007).

Në ditët e sotme, të mësuarit profesional gjatë gjithë jetës paraqet një pjesë të rëndësishme të çdo institucioni shëndetësor dhe të politikës së kujdesit shëndetësor në mbarë botën. Disa studime kanë treguar se të mësuarit gjatë gjithë jetës është një domosdoshmëri për çdo profesionist shëndetësor (Abernethy et al., 2010; Adler 2011; Guadalupe-Grau et al. 2009; Archambault et al., 2012). Ekzistojnë dëshmi inkurajuese që mbështesin një lidhje/marrëdhënie pozitive parashikuese midis pjesëmarrjes në Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional (ZHVP) dhe performancës mbi vlerësimet kolegjiale në praktikë (Bocalini et al., 2009).

## **Menaxhimi i rehabilitimit social**

Menaxhmenti është mjete që lubrifikon dhëmbëzoret, në mënyrë që të gjitha pjesët e makinës të vazhdojnë të funksionojnë pa probleme. Ai siguron që integriteti strukturor dhe praktik funksionojnë mirë së bashku në të gjithë sistemin e rehabilitimit social. Roli i menaxhmentit mund të ndahet në katër segmente progresive: vlerësimi i situatës arsimore ose shëndetësore; identifikimi i problemeve, shqetësimeve ose pengesave; zgjedhja dhe propozimi i ndërhyrjeve dhe/ose zgjidhjeve të përshtatshme; vlerësimi i rezultateve.

Menaxherët marrin rolin udhëheqës në krijimin e hapësirës për zhvillimin e zgjidhjeve, duke mbajtur takime me stafin, me fokus grupe, duke folur me individët dhe duke kërkuar këshillën e përdoruesve të shërbimit për të kontribuar në perceptimet e tyre për problemet. Menaxherët përcjellin strategjitë e zbatimit për të vlerësuar rezultatet e zgjidhjeve të problemeve. Pas vendosjes së zgjidhjes dhe zbatimit të propozuar, ata përcaktojnë datat specifike të rivlerësimit për të siguruar që rezultatet e dëshiruara po arrihen.

Për më tepër, nevoja e vazhdueshme për të kufizuar mbulimin e kujdesit të kushtueshëm rezidencial dhe për të zvogëluar kohën e qëndrimit në spital po shpjen në përfshirjen e rehabilitimit si një aktivitet kryesor të shërbimeve sociale, ndërsa duket se mënyra më e mirë e promovimit dhe mundësimit të procesit të rehabilitimit social, është përmes zhvendosjes së

përgjegjësive të stafit të kujdesit shtëpiak (ekspertë social dhe të kujdesit shëndetësor) drejt lehtësimit të detyrave të thjeshta rehabilituese (Mountain, 2011). E gjithë ideja e transformimit dhe shndërrimit të burimeve ekzistuese institucionale dhe gjetjes së burimeve të reja dhe të ndryshme cilësore (Rotelli et al., 2004), duke ruajtur fokusin në bashkëpunimin shumë-disiplinar, paraqet një sfidë unike në rehabilitimin social.

Sidoqoftë, sugjerohet që përfshirja e shërbimeve të kujdesit të ndërmjetëm duhet të jetë në kontekstin e konfigurimit të përgjithshëm të shërbimeve të ofruara në një lokalitet, si dhe të bashkojë praktikën më të mira për rehabilitimin klinik dhe social (Mountain, 2011), me sugjerime se një qasje e tërë sistemit është mënyra më efektive për t'iu përgjigjur nevojave të rehabilitimit (Herbert et al., 2000). Megjithatë, i takon menaxherit që të marrë parasysh implikimet e plota të ndryshimit të natyrës së shërbimeve të kujdesit shtëpiak, nga një funksion kujdesi në atë mundësues (Mountain, 2011).

### **Menaxhimi i cilësisë**

Menaxhmenti siguron që të gjithë ofruesit e shërbimeve janë duke përdorur parimet, qasjet, metodat dhe teknikat e praktikave më të mira. Menaxherët sigurojnë që praktika më e mirë të përfshijë një qasje të përqendruar në përdoruesin e shërbimit, që siguron respektimin e kodeve të etikës dhe të sjelljes profesionale gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore dhe arsimore.

Disa nga detyrat për të siguruar cilësinë e shërbimeve mund të përfshijnë (kjo nuk është një listë e plotë):

- a. Mentorimin;
- b. Motivimin e të tjerëve;
- c. Ofrimin e mundësive për zhvillim të stafit;
- d. Planifikimin strategjik;
- e. Mbledhjen e informacionit të bazuar në dëshmi;
- f. Komunikimin e informacionit të bazuar në dëshmi për ofruesit e shërbimit;
- g. Përzgjedhjen dhe organizimin e stafit në një mënyrë që lejon stafin të jenë të shkëlqyeshëm në shkathtësitë e tyre dhe përdoruesit e shërbimit të marrin shërbime me cilësi të lartë;
- h. Largimin e stafit që vendos përdoruesit e shërbimit në rrezik të shëndetit fizik, emocional dhe psikik;
- i. Ofrimin e dokumentacionit konsistent dhe efikas;
- j. Komunikimin dhe bashkëveprimin me të gjitha nivelet e menaxhmentit dhe ofruesve të shërbimit;
- k. Vendosjen e standardeve të praktikës për ofruesit e shërbimit;
- l. Monitorimin e performancës së ofruesve të shërbimit, projekteve dhe programeve;

### **Përfshirja e përdoruesit**

Përdoruesi i shërbimit (pacienti, klienti dhe studenti) fuqizohet dhe inkurajohet nga ofruesi i shërbimit (profesionisti shëndetësor, staf arsimor) për të shprehur prioritetet e tyre në lidhje

me rezultatet e dëshiruara shëndetësore dhe arsimore. Përdoruesi i shërbimit lejohet dhe inkurajohet të përfshihet në procesin e ofrimit të shërbimeve të plota shëndetësore dhe arsimore. Me fjalë tjera, në kontekstin shëndetësor, atyre u kërkohet leje para se të mund të ofrohen shërbimet. Atyre u jepen opsione të ndërhyrjes. Ata përfshihen në procesin e përcaktimit të qëllimeve dhe planet e ndërhyrjes zhvillohen në bashkëpunim me përdoruesin e shërbimit. Strategjitë e ndërhyrjes janë të dizajnuara për të marrë parasysh vlerat dhe pikëpamjet e përdoruesve të shërbimit.

Në një mjedis edukimi, studentëve u jepet mundësia për të bashkëvepruar dhe për të marrë përgjegjësi për të nxëniet e tyre. Instruktorët e lëndës i planifikojnë ligjëratat e tyre në mënyrë që të përfshijnë kreativitetin e studentëve në dizajnimin e metodave për të nxënë dhe demonstruar njohuritë e tyre të informacionit të mësuar. Materiali mësimor shpërndahet në atë mënyrë që përfshin të gjitha stilet e të nxëniet të studentëve (stilin pamor, dëgjimor, kinestetik, të prekjes, etj...).

### **Bashkë-krijimi**

Bashkë-krijimi është një qasje grupore, ku përdoruesi i shërbimit dhe ofruesi i shërbimit janë partnerë të barabartë në zhvillimin dhe krijimin e metodave, teknikave dhe zhvillimit të programeve për zgjidhjen e problemeve. Të gjithë akterët mblidhen së bashku për të ofruar mendimet e tyre mbi identifikimin e problemeve dhe zgjidhjen e tyre. Kur zhvillohet bashkë-krijimi, ai lehtëson përqafimin e vlerave, prioritetëve, pritjeve të arritshme, temave dhe kulturave individuale dhe të korporatave, që janë kuptimplota për të gjithë akterët. Të gjithë pjesëmarrësit janë bashkë-krijues të programeve, metodave të të nxëniet, ndërhyrjeve shëndetësore dhe zhvillimit të komunitetit që do të mundësojnë tejkalimin e boshllëqeve në fushat që i pengojnë individët dhe komunitetet që të arrijnë rezultatet e dëshiruara shëndetësore dhe arsimore.

### **Praktika e bazuar në dëshmi**

Qasja e kontekstualizuar (bazuar në kulturë), bazuar në një proces hap-pas-hapi (hulumtimi, mbledhja, vlerësimi dhe zbatimi në praktikë) drejt një rehabilitimi me qendër personin.

Praktika e bazuar në dëshmi (PBD) përfshin përdorimin e llojeve të ndryshme të hulumtimit kur merren vendime në lidhje me politikën dhe praktikën. PBD-ja merr parasysh:

- Dëshmitë më të mira në dispozicion të hulumtimit
- Preferencat dhe vlerat e klientit
- Rrethanat dhe gjendjen klinike
- Eksperiencën dhe njohuritë e mjekut

## 2. Kompetenca e mësimitdhënës - Përkufizimi i shkathtësive

*Shaban Buza, Bujar Gallopi, Kushtrim Grezda, Kushtrim Veliu, Skender Uka*

Ky raport ka të bëjë me ndikimin e kompetencës së mësimitdhënës në të gjithë procesin e arsimit. Tema kyçe është avancimi i metodave të edukimit social dhe përfshirja e metodave të ndryshme që synojnë arritjen e kompetencave të mësimitdhënësve në bashkëpunim me studentët.

Teknikat efektive të mësimitdhënies tani janë një kërkesë për çdo mësimitdhënës dhe ato mund të mësohen dhe përsosen si çdo shkathtësi tjetër. Çdo mësimitdhënës i mjekësisë pritet të japë mësim, si për studentët e infermierisë, për mamitë, ashtu edhe për profesionistët ndërlidhura të shëndetësisë. Për më tepër, ekziston një pritshmëri për të prezantuar trajnime formale në metodat e mësimitdhënies. Një mësimitdhënës i pasionuar do të jetë aset shumë i vlefshëm për çdo departament të arsimit mjekësor. Ekzistojnë shumë shkathtësi që e bëjnë një mësimitdhënës të mirë mjekësor. Disa nga më të rëndësishmet janë: i qasshëm, entuziast, udhëheqës, mentorim pacienti, lehtësues, student, i besueshëm, logjik, i ditur etj.

### **Përkufizimi i kompetencës**

Koncepti dhe përkufizimi i kompetencës kuptohet si një zotësi e shkëlqyeshme që përfshin njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe përvojat të cilat duhet të synohen (Slavik, 2008). Në vend të kësaj, ngritja e kompetencave është identifikuar si objektivi kryesor i arsimit. Koncepti i kompetencës është thelbësor për studimet empirike që kanë të bëjnë me zhvillimin e burimeve njerëzore dhe produktivitetin e arsimit (Sternberg & Grigorenko, 2003).

### **Përmirësimi i shkathtësive dhe kompetencave të mësimitdhënies**

Është jetike të kesh një kuptim themelor të mënyrës së të nxënimit të të rriturve, stileve të ndryshme të të nxënimit, mënyrës së përshtatjes së mësimitdhënies në situata të ndryshme dhe një kuptim të mësimitdhënies. Shumë mund të mësohet edhe nga vëzhgimi dhe diskutimi i metodave të mësimitdhënies me mësimitdhënësit me përvojë. Kjo mund të zgjerohet më tej në formën e mentorimit. Dobitë potenciale të këtij modeli janë të mëdha, por mund të përfshijnë këshilla, udhëzime, lehtësim të resurseve dhe këshillim rreth situatave të vështira të mësimitdhënies. Mentori zakonisht është një koleg i lartë i cili mund të ofrojë informata kthyesë pozitive dhe negative në një mënyrë jo-gjyquese. Kompetencat në lidhje me inovacionin i referohen prezantimit të ideve, kreativitetit, rrjetëzimit, përshtatshmërisë, efikasitetit, komunikimit, punës grupore dhe përgjegjësisë sociale. Studentët e mbështesin këtë perceptim në lidhje me punën grupore, por vetëvlerësimi i tyre sugjeron gjithashtu që duhet kushtuar më shumë vëmendje zhvillimit të kompetencave tjera, veçanërisht atyre që kanë të bëjnë me lidhësin (Kopelyan, Godonoga & Yasmin, 2016).

### **Përfshirja e ndihmës së teknologjisë bashkëkohore**

Dekada e kaluar ka shënuar një rritje eksponenciale në përdorimin e teknologjisë bashkëkohore në fushën e arsimit mjekësor. E-learning (mësimi elektronik) dhe webcasting (transmetimi përmes uebit) janë shembuj të strategjive arsimore që janë bërë të zakonshme në shumë institucione mjekësore. Kohëve të fundit, interesi është zhvendosur drejt përdorimit të teknologjive mobile për të përmirësuar të nxënimit. Tabelat interaktive të bardha kombinojnë tabelën tradicionale, projektorin dhe tabelën e bardhë. Këto janë sipërfaqe të ndjeshme ndaj



prekjes që janë të lidhura me një kompjuter dhe një projektor digjital. Ato mund të jenë të dobishme në të nxënit e bazuar në probleme kur punojnë në grupe të vogla. Arsimi mjekësor i bazuar në simulime i lejon studentët të përdorin një sërë burimesh që synojnë të imitojnë situatat e jetës reale. Simulimi përfshin modele procedurale thjeshtuese (replikim i ulët i realitetit) që janë përdorur për shumë vite për të ndihmuar individët në detyrat specifike të shkathtësive klinike - për shembull, modelet urogjenitale për kateterizim.

Këtu përfshihen metodat e fushave të caktuara që ndikojnë në përmirësimin e nivelit të arsimit, veçanërisht në disa fusha të rehabilitimit, si ergoterapia dhe profesionet tjera të ndërlydhura, për shembull (Kompetencat dhe Standardet e Performancës, 2015):

- Kërkesa për punë bashkëpunuese
- Arsimi për karrierë mjekësore
- Arsimi teknologjik
- Teknologjia automobilistike
- Hartimi dhe projektimi me ndihmën e kompjuterit
- Teknologjia inxhinierike
- Sistemet digjitale të video produksionit
- Teknologjia e drurit

### **Hulumtimi dhe sfidat e tij**

Ashtu si në mjekësinë klinike, praktika e bazuar në dëshmi në arsimin klinik është shumë i rëndësishëm. Si edukator mjekësor dhe social është thelbësore të sigurohet se metodat e përdorura, në të cilat ekziston një investim i konsiderueshëm financiar në nivel kombëtar të përmirësimit praktikë e profesioneve të ardhshme të kujdesit shëndetësor dhe prandaj të përmirësimit edhe rezultatet e pacientëve. Dëshmitë e cilësisë së lartë janë të nevojshme për hartimin/krijimin e politikave dhe praktikave të standardeve më të larta. Hulumtimi bashkëkohor i arsimit përballet me sfida të shumta, të tilla si financimi që duhet të zgjidhet nga mësimdhënësi dhe niveli menaxherial.

Shumë studentë tani kanë mundësinë për të marrë kualifikime formale dhe bursa. Përsosmëria arsimore, së bashku me përsosmërinë klinike gjithnjë e më shumë po njihen dhe shpërblehen në mënyrën e duhur. Sidoqoftë, duhet të kemi përmirësime të vazhdueshme në mënyrën e mësimdhënies dhe të mirëpresim mënyra të reja të mësimdhënies, duke mos harruar synimin kryesor: të përmirësohemi në trajtimin e pacientëve dhe të ofrojmë kujdes shëndetësor me cilësi të lartë.

Hulumtimi në praktikën e rehabilitimit social është një fushë në zhvillim e sipër dhe baza e dëshmive është më e mirë për disa aspekte sesa për të tjerat. Nevoja për të kuptuar se çfarë funksionon në praktikën aktuale të rehabilitimit social është jetike nëse duam të kuptojmë efektivitetin e modeleve të rehabilitimit social të ndërhyrjes dhe të zhvillojmë një bazë të dëshmive që ndihmon në rritjen e cilësisë së rehabilitimit social.

Studimet nga Moore et al. (2014), Albert et al. (2002), Challis et al. (2002) dhe Engelhardt et al. (2006) sugjerojnë se p.sh. efikasiteti i punëtorëve socialë ishte kryesisht i bazuar në një kombinim të shkathtësive. Këto përfshinin vlerësimin, njohuritë rreth burimeve lokale dhe aftësinë për të ofruar këshillim dhe/ose mbështetje të vazhdueshme.

### **Përdorimi i emocioneve si shkathtësi mësimdhënies**

Hulumtimi mbi të nxënit dhe neurobiologjinë sugjeron që qendra e trurit të njeriut që përpunon emocionet është e lidhur ngushtë me ato që përpunojnë dhe ruajnë informacionin e ri. Me fjalë të tjera, mësimet e nxjerra në kontekstin e emocioneve të forta ndryshohen nga këto emocione. Emocionet negative si zemërimi ose ankthi mund të ndërhyjnë në procesin e të nxënit, sepse ato ndryshojnë shkathtësinë e studentit për të përpunuar informacionin në mënyrë efikase . Në mënyrë të ngjashme, emocionet pozitive mund të pakësojnë ankthin dhe të nxisin studentin të marrë më shumë rreziqe dhe të ndjekë sjellje pozitive të të nxënit, siç janë parashtrimi i pyetjeve, vërja në dyshim e supozimeve dhe testimi i hipotezave.

### **Një kornizë kyçe e njohurive, shkathtësive dhe kompetencave për mësimdhënësit**

Zhvillimi i njohurive, shkathtësive dhe kompetencave kyçe për mësimdhënësit e rehabilitimit social bazohet në dimensionet e mëposhtme:

- Mësimdhënia në programet e arsimit të rehabilitimit social;
- Monitorimi dhe mbështetja e studentëve;
- Testimi i studentëve;
- Zhvillimi i kurrikulave dhe trajnimeve gjatë gjithë jetës;
- Mësimdhënia e bazuar në dëshmi;
- Publikimi;
- Përfaqësimi i profesionit.

Zhvillimi i kompetencave të mësimdhënësve është i ndryshëm nga arsimit formal (zhvillimi i mësimdhënësve para-shërbimit) dhe aftësimi jo-formal (zhvillimi i mësimdhënësve në shërbim). Në arsimin formal, përdoret transferimi i veçantë i kredive, si për shembull Sistemi Evropian për Transfer të Kredive (ECTS), ku një ECTS është ekuivalent me 25-30 orë mësimi (1 orë = 45 minuta). Ndërsa në arsimin joformal, kreditë jepen më shumë në një qasje modulare, bazuar në kurrikulat e zhvilluara të trajnimit.

•

### 3. Pedagogjia bashkëkohore

*Fitim Uka, Mimoza Hasani, Mimoza Dushi, Rudine Fetahaj*

#### **Nxënia e bazuar në probleme**

Nxënia e bazuar në probleme është një nga metodat pedagogjike më të njohura dhe më me ndikim, e cila përdoret gjerësisht në edukimin mjekësor. PBL mund të konsiderohet si një mjedis i të nxënit ku problemi nxit të nxënit. Kryesisht, procesi i të nxënit zhvillohet në grupe të vogla dhe mbikëqyret nga tutorët (Klegeris & Hurren, 2011). Në vend që të ushqej trurin e studentit me informata, PBL zgjedh të imitojë procesin natyral të të nxënit, ku studentët mësojnë përmes veprimt, mësojnë duke bërë lidhjet me ato që tashmë i dinë, përmes bashkëpunimit me të tjerët dhe përmes gabimeve. Në PBL, problemi u paraqitet studentëve fillimisht dhe studentët formulojnë hipoteza që mund të shpjegojnë problemin dhe më pas përcaktojnë se çfarë informata të mëtejshme kërkohen për të kuptuar më mirë problemin. "Studentët pastaj hulumtojnë në mënyrë të pavarur dhe mbledhin informata për të sqaruar hipotezat e tyre, të cilat në fund të fundit i ndihmojnë ata të krijojnë kuptime të reja personale rreth problemit të Learthe. Këto kuptime personale ndahen më pas me grupin dhe arrihet një mirëkuptim bashkëpunues" (Universiteti i Notre Dame, 2017, f. 3). Ekzistojnë shumë përparësi të të nxënit të bazuar në probleme (PBL) në krahasim me kurrikulat tradicionale. Integrimi i përmirësuar i shkathtësive themelore dhe klinike, komunikimi i përmirësuar, shkathtësitë e punës ekipore dhe shkathtësitë e të nxënit të vetë-orientuar, një format më i kënaqshëm dhe motivues janë vetëm disa nga avantazhet ndaj qasjeve tradicionale (Onyon, 2012).

#### **Nxënia e bazuar në projekte**

Në nxënien e bazuar në projekte, studentët zgjedhin dhe punojnë në mënyrë bashkëpunuese për të hetuar dhe zgjidhur problemet sfiduese që janë autentike, reale, të bazuara në kurrikula dhe shpesh ndërdisiplinore (Bell, 2010, Colley, 2008). Të nxënit e bazuar në projekte krijojnë student aktivë. Studentët marrin përgjegjësi, bëjnë pyetje, marrin vendime, analizojnë, mendojnë në mënyrë kritike, krijojnë, prezantojnë. Në procesin e të nxënit, i cili përfshin të nxënit e bazuar në projekte, roli i mësuesit është të udhëzojë dhe këshillojë, e jo të drejtojë dhe menaxhojë punën e studentëve (Solomon, 2003).

#### **Nxënia e bazuar në simulime**

Nxënia e bazuar në simulime është një metodë mësimore që u lejon studentëve të zhyten në një mjedis interaktiv dhe realist ku shkathtësitë, njohuritë dhe qëndrimet mund të zhvillohen pa rrezik ndaj pacientëve dhe u ndihmon studentëve të kuptojnë problemet dhe t'i menaxhojnë ato kur ndodhin në të vërtetë në praktikën klinike (Hovancsek 2007, Lateef, 2010). Më konkretisht, simulimi është një person, një pajisje ose një grup kushtesh, të cilat përpiqen të paraqesin dhe zgjidhin problemet në mënyrë autentike (Sharma, 2017). Ekzistojnë disa mënyra për të organizuar simulimin në mjediset klinike, siç janë: luajtja e roleve, pacientët e standardizuar, modelet, simulimet tre dimensionale si manekinët, simulimet e realitetit virtual, simulimet kompjuterike, ndërveprimet me video. Ekzistojnë dëshmi se simulimi është një mjet efektiv i të nxënit sidomos për komunikimin me pacientin (Kneebone et al. 2006). Luajtja e roleve me akterët dhe mjediset virtuale online mund të

përdoret gjithashtu për të simuluar mjedisin klinik (Seropian et al. 2004, Medley & Horne, 2005).

### **Nxënia e kombinuar**

Nxënia e kombinuar përkufizohet si kombinim i të nxënit online dhe balle përballe, në mënyrë që të lehtësohet përfitimi i njohurive dhe shkathtësive. Megjithëse ekziston një mungesë konsensusi në përkufizim, të nxënit e kombinuar përkufizohet si "të nxënit që ndodh në një kontekst mësimor i cili karakterizohet nga një kombinim i qëllimshëm i ndërhyrjeve online dhe të bazuara në klasë për të nxitur dhe mbështetur të mësuarit" (Boelens, Van Laer, De Wever, & Elen, 2015, f.5). Të nxënit e kombinuar përfshin një komponent të rëndësishëm online, por kërkon integrimin efektiv të metodave virtuale dhe të drejtpërdrejta (Garrison & Kanuka, 2004). Si i tillë, ligjëruesi mund të vendosë materialet e lëndës në një mjedis virtual mësimi, por gjithashtu ofron konsultime dhe lehtësime të drejtpërdrejta. Qëllimi i të nxënit të kombinuar është të fuqizojë individin të arrijë kuptimin e një teme të caktuar, të bëhet i pavarur, të përmirësojë performancën e tij ose të saj dhe përfundimisht të nxisë rezultatet që mbështesin objektivat e biznesit (Woodall, 2012).

### **Nxënia e informuar nga hulumtimet**

Studentët mund të mësojnë nga, rreth dhe përmes hulumtimit (Hodson, 1992). Nxënia përmes metodës së hulumtimit do të thotë që studentët fitojnë njohuri për disiplinën e tyre duke bërë vetë hulumtime (Qendra për Arsim dhe Mësim, CEL, 2016). Në këtë metodë ndarja e të mësuarit ndërmjet mësuesit dhe studentit minimizohet dhe metoda e mësimdhënies bazohet në bashkëpunim/dialog. Në këtë metodë, studentët janë të angazhuar në gjetjen e përgjigjeve përmes hulumtimit, në vend të metodave të tjera.

### **Lehtësimi i të nxënit (mbikqyrja dhe trajnimi)**

Në teknikat pedagogjike më bashkëkohore, roli i mësimdhënësit është të lehtësojë procesin e të nxënit. Për shembull, Barrows (2010) besonte se mbikëqyrësi duhet të ketë ekspertizë në lehtësimin e procesit brenda grupit (ekspertizë të procesit) më shumë sesa në një fushë lëndore (ekspertizë të përmbajtjes). Mësimdhënësit nuk kanë më nevojë të jenë burimi i vetëm i informacionit, duke pasur parasysh qasjen në informata që ofron teknologjia, kështu që ka kuptim që mësimdhënësit të kalojnë në rolin e lehtësuesit të njohurive (dhe jo të ofruesit) (Maudsley, 2009). Në vend që mësimdhënësit të ofrojnë informata kthyese, ata mund t'i udhëzojnë studentët që t'i japin informata kthyese njëri-tjetrit dhe mësimdhënësi të ofron një strukturë dhe pyetje udhëzuese për t'u siguruar që informatat e tyre kthyese ishin të dobishme, pastaj tërhiqet për të lejuar diskutimet ndër-kolegiale (Martinez, McGrath, & Foster, 2016). Gjithashtu, mësimdhënësit në pedagogjinë bashkëkohore kanë rolin e trajnuesit. Trajnimi mund të shihet si një proces i zhvillimit njerëzor që përfshin ndërveprimin e fokusuar midis trajnerëve dhe të trajnuarve dhe përdorimin e strategjive, mjeteve dhe teknikave të duhura me qëllim nxitjen e ndryshimeve të dëshirueshme dhe të qëndrueshme njohëse, emocionale dhe të sjelljes, që lehtësojnë mirëqenien, arritjen e qëllimit dhe performancën e përmirësuar në fushën e punës dhe të jetës personale me popullsi jo-klinike (Cox, Bachkirova, & Clutterbuck, 2010).

## 4. Bashkë-krijimi

*Jennifer Caldwell, Bujar Gallopeni, Anisa Hasani, Adnan Hoxha*

### Çfarë janë bashkë-krijimi dhe bashkë-projektimi?

Bashkë-krijimi është term shumë i gjerë që ngërthen një gamë të gjerë aplikimesh. Bashkë-krijimi përkufizohet si çfarëdo veprimi i krijimtarisë kolektive nga dy ose më shumë persona. Bashkë-krijimi konsiderohet si rast i veçantë i bashkëpunimit, ku qëllimi është që të krijohet diçka që nuk dihet paraprakisht. Koncepti i bashkë-projektimit lidhet drejtpërdrejt me bashkë-krijimin. Bashkë-projektimi identifikohet si krijimtari kolektive pasi aplikohet në të gjithë hapësirën e një procesi të projektimit. Me këto përkufizime, bashkë-projektimi është një rast specifik i bashkë-krijimit (Díaz-Méndez & Gummesson, 2012)

Ekzistojnë shumë lloje të ndryshme të bashkë-krijimit që zhvillohen në ditët e sotme, ku përfshihen:

- Bashkë-krijimi brenda komuniteteve;
- Bashkë-krijimi brenda kompanive dhe organizatave;
- Bashkë-krijimi midis kompanive dhe partnerëve të tyre të biznesit;
- Bashkë-krijimi midis kompanive dhe personave që ato u shërbejnë, të cilët quhen ndryshe klient, konsumator, përdorues ose përdorues fundor;

Prandaj, fokusi i këtij lloji të bashkë-krijimit është ajo që ndodh ndërmjet organizatave dhe njerëzve që ato u shërbejnë.

Doracak është i organizuar në dy pjesë, njëra mbi përkufizimin e bashkë-krijimit, tjetra mbi përdorimin e tij:

### Çfarë është bashkë-krijimi?

Bashkë-krijimi është një koncept kyç në zhvillimin e shërbimeve publike (Bovaird, 2007). Ai ka potencialin për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në të gjitha sfidat e mëdha me të cilat përballen shërbimet shëndetësore dhe të kujdesit social. Ky është një doracak që përkufizon bashkë-krijimin dhe mënyrën e zhvillimit të një qasjeje bashkë-krijuese për të punuar me njerëzit që përdorin shërbimet dhe kanë karrierë. Është i synuar për menaxherët dhe komisionerët, praktikantët që punojnë me palë dhe njerëzit që përdorin shërbime dhe kanë karrierë. Bashkë-krijimi mund të mbështesë:

- Shërbimet me kosto efektive;
- Përvojën e përmirësuar të përdoruesve dhe karrierës së shërbimeve;
- Rritjen e kapacitetit të komunitetit;
- Shërbimet e fokusuar në rezultatet dhe shërbimet parandaluese;
- Integrimin;

Ideja që shërbimet publike duhet të punojnë me njerëzit që përdorin shërbime nuk është e re (Bovaird, 2007). Megjithatë, mos-marrja parasysh e komenteve të njerëzve që përdorin shërbime dhe kanë karrierë ka qenë temë kyçe në të gjitha skandalet e profilit të lartë në kujdesin shëndetësor dhe social gjatë viteve të fundit. Kërkesat mbi abuzimin dhe neglizhimin e njerëzve që përdorin shërbime, kanë theksuar nevojën që ofruesit të zhvillojnë marrëdhënie më të barabarta me njerëzit që përdorin shërbimet dhe kanë karrierë. Bashkë-krijimi ofron konceptin dhe kornizën për të zhvilluar këto marrëdhënie më kuptimplota. Në

veçanti, bashkë-krijimi duhet të përdoret për të zhvilluar shërbimet parandaluese, të bazuara në forcë, për të mbështetur vlerësimin, për të formuar tregun e kujdesit lokal dhe për të planifikuar shërbimet e informacionit dhe këshillimit.

Ekziston një interes për bashkë-krijim në të gjithë gamën e plotë të shërbimeve publike, jo vetëm për kujdesin social dhe shëndetësor. Organizatat e sektorit publik dhe privat dhe politikanët nga tri partitë kryesore kanë treguar interes për bashkë-krijim. Ky interes është pjesërisht i motivuar nga presioni për të ulur shpenzimet por është gjithashtu tregues i faktit të mirënjohur që qytetari ka një rol jetësor në arritjen e rezultateve pozitive nga shërbimet publike (Bovaird, 2007).

Zbatimi i bashkë-krijimit është sfidues dhe kompleks. Ai përfshin shqyrtimin e çdo aspekti të mënyrës së funksionimit të një organizate. Ky burim mbështetet në të nxënit nga një gamë e gjerë burimesh për të ndihmuar menaxherët, praktikantët, njerëzit që përdorin shërbimet dhe kanë karrierë të kuptojnë dhe zbatojnë bashkë-krijimin në kujdesin social dhe më tej.

### **Si të zhvillohet bashkë-krijimi<sup>1</sup>**

Rekomandimet në vijim janë të bazuara në një kornizë për menaxhimin e ndryshimeve të strukturuar rreth një enigme prej katër pjesësh që trajton kulturën, strukturën, praktikën dhe rishikimin. Rekomandimet kategorizohen në katër grupet kryesore në vijim:

#### ***Kultura***

- Sigurohuni që bashkë-krijimi është pjesë e kulturës së një organizate.
- Sigurohuni që kjo kulturë të mbështetet mbi një kuptim të përbashkët të asaj që bashkë-krijimi është një grup parimesh për vënien e qasjes në veprim si dhe përfitimet dhe rezultatet që do të arrihen me këtë qasje.
- Sigurohuni që organizatat të zhvillojnë një kulturë që është e vetëdijshme ndaj rrezikut dhe jo e frikësuar nga rreziku.

#### ***Struktura***

- Përfshini të gjithë ata që do të marrin pjesë në bashkë-krijim që nga fillimi.
- Vlerësoni dhe shpërbleni njerëzit që marrin pjesë në procesin e bashkë-krijimit.
- Sigurohuni që të ketë burime për të mbuluar koston e aktiviteteve të bashkë-krijimit.
- Sigurohuni që bashkë-krijimi të mbështetet nga një strategji që përshkruan se si do të komunikohen gjërat.
- Mbështetuni në strukturat dhe burimet ekzistuese.

#### ***Praktika***

- Sigurohuni që gjithçka në procesin e bashkë-krijimit të jetë e arritshme për të gjithë që marrin pjesë dhe të mos përjashtohet asnjë.
- Sigurohuni që të gjithë personat e përfshirë të kenë informata të mjaftueshme për të marrë pjesë në bashkë-krijim dhe vendimmarrje.

---

<sup>1</sup> Shembuj të bashkë-krijimit: <http://eprints.gla.ac.uk/86126/>

- Sigurohuni që të gjithë personat e përfshirë të jenë të trajnuar në parimet dhe filozofinë e bashkë-krijimit dhe në çfarëdo shkathtësish që iu nevojiten për punën që ata bëjnë.
- Mendoni nëse një lehtësues i pavarur do të ishte i dobishëm për të mbështetur procesin e bashkë-krijimit.
- Sigurohuni që stafit pritës t'u jepet mundësia të punojnë duke përdorur qasje të bashkë-krijimit, së bashku me kohën, burimet dhe fleksibilitetin.
- Ofroni çdo mbështetje që është e nevojshme për të siguruar që komuniteti i përfshirë ka kapacitetin të jetë pjesë e procesit të bashkë-krijimit.
- Sigurohuni që politikat dhe procedurat të promovojnë kryerjen e shërbimeve që përdorin qasjet e bashkë-krijimit.
- Sigurohuni që ekzistojnë politika për bashkë-krijim në procesin aktual të realizimit.

### ***Rishikimi***

- Kryeni rishikime të rregullta për të siguruar që bashkë-krijimi po bën një ndryshim real dhe se procesi po ndjek parimet e dakorduara.
- Bashkë-krijoni rishikime dhe vlerësime.
- Përdorni gjetjet e rishikimit për të përmirësuar mënyrat e zbatimit të parimeve të bashkë-krijimit, në mënyrë që të zhvillohet mësimi i vazhdueshëm.
- Gjatë rishikimeve dhe vlerësimeve, punoni me njerëzit që përdorin shërbimet dhe kanë karrierë, për të menduar rreth mënyrave që tregojnë ndikimin që bashkë-krijimi ka, si dhe proceset që janë të përfshira.

### **Bashkë-krijimi i metodës së mësimdhënies**

***Përfitimet*** – literatura relevante tregon përfitimet e mëposhtme të metodës së mësimdhënies bashkë-krijuese: marrëdhëniet e përmirësuara student-staf dhe zhvillimi i një sërë tiparësh të të diplomuarit; motivimi dhe të nxëniet; rritja e ndërgjegjësimit meta-njohës dhe një ndjenjë më e fortë identiteti; përvojat e përmirësuara të mësimdhënies dhe klasës; dhe angazhim i përmirësuar (Bovill, Cook-Sather, Felten, Millard, & Moore-Cherry, 2015).

***Sfidat*** – përkundër përfitimeve të shumta, metoda e mësimdhënies bashkë-krijuese është e lidhur edhe me këto tri tema të gjera sfidash: rezistenca ndaj bashkë-krijimit të të mësim-nxënies dhe mësimdhënies, krijimi i një qasjeje gjithëpërfshirëse, drejtimi i strukturave, praktikave dhe normave institucionale.

***Tejkalimi i sfidave*** – sigurimi i transparencës së plotë gjatë procesit të bashkë-krijimit të njohurive është mënyra më së shpeshti e rekomanduar për të tejkaluar sfidat e sipërpërmendura. Për më tepër, angazhimi i të gjitha palëve në diskutim argumentohet se shmanë në mënyrë efektive ankthin rreth të panjohurës dhe shqetësimin se shpjegimet e duhura për mësim nuk do të sigurohen.

***Aplikimet*** – ka forma të ndryshme që bashkë-krijimi mund të marrë kur aplikohet në institucione të ndryshme, pasi që sfidon normat nga këndvështrimet e ndryshme. Në të vërtetë, mund të përdoret në shkallë të ndryshme, të tilla si: adresimi i qëllimeve institucionale strategjike, operacionale dhe pedagogjike, lënda, iniciativë në klasë dhe iniciativat individuale. Më konkretisht, mund të aplikohet në rastet kur stafi dhe studentët bashkëpunojnë sa i përket bashkë-ri(projektimit) të përmbajtjeve të lëndës, hulumtimit në mësimdhënie dhe mësim-nxënie, ndërmarrjes së hulumtimeve disiplinore, zgjedhjes dhe/ose projektimit të mjeteve të vlerësimit, d.m.th. pyetjet e esesë, notimit të punës së të tjerëve dhe

punës së vet, vlerësimin të proceseve mësimore dhe përmbajtjes së lëndës (Bovill et al., 2015).

- 1.1 Përveç kësaj, modeli i bashkë-gjenerimit mund të përdoret si një mjet për gjenerimin dhe mbledhjen e ideve të pacientit, zhvillimin e kujdesit me në qendër pacientin bazuar në historinë e një pacienti të vetëm dhe ofrimin e një kuptimi më të mirë për përvojat e pacientëve mbi kujdesin shëndetësor (Elg, Engström, Witell, & Poksinska, 2012).



## 5. Planifikimi i lëndës

*Jennifer Caldwell, Anisa Hasani, Margriet Jaspers Focks, Shpresa Mehmeti, Adnan Hoxha*

### **Për kë synohet ky doracak?**

Nëse jeni i ri në trajnim apo ende jeni duke e marrë veten, ky doracak do t'ju ndihmojë përgjatë procesit të përgjithshëm të planifikimit të lëndës. Planifikimi i lëndës nënkupton vendosjen paraprakisht se çfarë duhet bërë, kur, ku, si dhe nga kush duhet të bëhet. Planifikimi shërben për ta tejkaluar hendekun nga pozita ku ne jemi deri aty ku duam të shkojmë. Ai përfshin përzgjedhjen e objektivave, politikave, procedurave dhe lëndëve në mesin e alternativave. Plani është një lëndë e paracaktuar e veprimit për të arritur një qëllim të caktuar. Është një proces intelektual i karakterizuar nga të menduarit para të vepruarit. Është një përpjekje nga ana e menaxherit që të parashikojë të ardhmen në mënyrë që të arrihet performanca më e mirë. Planifikimi është funksioni parësor i menaxhmentit (Fink, 2015).

### **Para se të filloni planifikimin e lëndës**

Kini parasysh nëse ekziston një proces specifik në organizatën tuaj që duhet ndjekur për të përcaktuar projektimin e përgjithshëm të iniciativës suaj të trajnimit. Nëse ekziston një proces i caktuar, sigurohuni që të ndiqni hapat që janë hedhur në vend që të përdorni hapat e mëposhtëm.

Nëse dokumenti përmbledhës ose specifikacioni i trajnimit që keni krijuar nga lënda është mjaft i detajuar, ju mund ta anashkaloni këtë fazë dhe të vazhdoni drejtpërdrejt me projektimin e secilit sesion në detaje. Për të qenë në gjendje të projektoni çdo sesion në detaje, duhet të jenë të qarta pikat e mëposhtme:

- Titulli i punës për lende dhe për secilën sesion
- Rezultatet e biznesit
- Objektivat e mësim-nxënies/rezultatet
- Popullata e synuar (pjesëmarrësit)
- Titulli për secilin sesion;
- Çdo sesion individual i strukturuar në radhitje logjike.

### **Planifikimi i secilit sesion**

Kur ofroni një lëndë, duhet të jeni i qartë se ku jeni, ku synoni të arrini dhe çfarë duhet të bëni në secilën fazë të ofrimit të lëndës. Për të arritur këtë, do t'ju duhet të krijoni udhëzuesin/doracakun e trajnerit. Një doracak i menduar mirë i trajnerit është veçanërisht i rëndësishëm kur zhvillohet një program trajnimi i cili do të ofrohet nga trajnerë të ndryshëm në vende të shumta. Por, edhe nëse po drejtoni një program të njëhershëm, prapëseprapë do t'ju duhet të krijoni një lloj doracaku për t'ju ndihmuar, ndonëse formaliteti dhe detajet mund të jenë në nivel më të vogël se sa që do të ishin për një numër më të madh trajnerësh.

### **Qëllimet e doracakut**

Ky doracak do t'ju ndihmojë të:

- Ndani trajnimin në sesione të ndryshme;

- Zhvilloni një sekuenca logjike dhe një rend drejtimi për çdo pjesë;
- Filloni të mendoni për mënyra të ndryshme që do të përdorni në secilën fazë;
- Planifikoni afatet e përafërta për çdo pjesë;
- Kontrolloni nëse projektimi juaj i përgjithshëm i plotëson rezultatet e kërkuara të biznesit dhe objektivat e të nxënës;

Secili prej sesioneve të trajnimit tuaj duhet të jetë i strukturuar mirë në aspektin e përmbajtjes dhe aktiviteteve në mënyrë që pjesëmarrësit të marrin maksimumin prej tij. Duhet ta krijoni një plan të detajuar për secilën pjesë të trajnimit tuaj. Sapo ta keni bërë këtë, do të jeni në gjendje të vazhdoni tutje që të krijoni më lehtë doracakun e trajnerit dhe shënimet e pjesëmarrësve. Merrni parasysh nëse ekziston një proces specifik për planifikimin e detajuar të secilit prej sesioneve tuaja të trajnimit. Nëse ekziston, sigurohuni që më tepër ta ndiqni atë proces në vend të hapave të përshkruar në pjesën në vijim.

### **Fazat e përgjithshme të planifikimit të lëndës**

1. Planifikimi i projektimit të përgjithshëm të lëndës
2. Planifikimi i secilit sesion në detaje
3. Krijimi i një doracaku të trajnerit
4. Krijimi i materialit të pjesëmarrësve
5. Projektimi i një ushtrimi në grup
6. Të shkruarit e skenarëve real dhe praktikë të shkathtësive
7. Asistimi i pjesëmarrësve në të kuptuarit e procesit
8. Kontrolli i të kuptuarit të pjesëmarrësve
9. Përdorimi i demonstrimit në trajnim
10. Sigurimi i mbështetjes për vetveten
11. Krijimi i një seance pilot të trajnimit
12. Një titull efektiv për lëndën tuaj
13. Përzgjedhja e vendit të duhur të trajnimit
14. Krijimi i materialeve angazhuese para lëndës
15. Përgatitja e mjedisit të trajnimit


## 6. Shtojcat

### I. TË NXËNIT E BAZUAR NË PROBLEME

**Bujar Gallopeni, Shpresa Mehmed**

#### Prezantimi i metodës

Metodologjia e të nxënit të bazuar në probleme (PBL) ka shtatë hapa që duhet ndjekur për një temë mësimi ose një rast studimor të problemit.



Qasja me shtatë hapa realizohet në dy sesione pune mes studentëve dhe mësimitdhënësve përgjatë javës, duke bërë pushime gjatë ditëve të javës ndërmjet këtyre 2 sesioneve. Gjatë sesionit të parë, studentët dhe mësimitdhënësi kalojnë nëpër pesë hapat e parë. Në hapin e gjashtë studentët lexojnë, këshillojnë dhe hulumtojnë burimet e literaturës (kryesisht të mësuarit individual, ose të mësuarit në çifte ose në grupe) për të kuptuar më mirë qasjet e zgjidhjes së problemeve. Sesioni i dytë përfshin hapin e shtatë, dhe ndërlihdët me diskutimin midis studentëve dhe shkëmbimin e njohurive nga burimet e literaturës së lexuar dhe hulumtuar për të arritur zgjidhjen e problemit.

#### Zbatimi

Gjatë kalimit nëpër shtatë hapat e PBL-së, mund të ndodh një kombinim i modaliteteve të punës midis studentëve, si puna në grup, punë individuale, dhe ndonjëherë punë në çifte. Më poshtë jepet një përshkrim i çdo hapi me ndarjen e detyrave dhe kohës.

Hapat	Aktivitetet	Koha	Një shembull i demonstruar duke përdorur metodën PBL
<p>Hapi 1</p>	<p><i>Njohja me problemin</i></p>	<p>Studentët e lexojnë problemin individualisht ose në çifte, dhe përpiqen ta kuptojnë atë.</p>	<p>Rasti i problemit:</p> <p>“Javën e kaluar, Robi, Zëvendës President i lartë në një kompani të madhe të naftës dhe gazit, u shfaq si mysafir në emisionin ‘Turning Managers into Leaders’ (Shndërrimi i menaxherëve në udhëheqës), duke folur në mënyrë specifike se si ndryshimi organizativ duhet të zbatohet ndryshe sot, nga se ishte bërë dhjetë apo pesëmbëdhjetë vite më parë. Sot, Robi është kthyer për të vazhduar dialogun, duke ofruar një shembull specifik se si duhet të zbatohet ndryshimi sot.</p> <p>Le të hedhim një vështrim në një shembull të kësaj “rruge të re” të cilës iu referova në postimin tim të fundit. Në një ndryshim të madh të kohëve të fundit në të cilin isha pjesë, paraqita një rast për ndryshim dhe disa mendime fillestare, por detajet e rastit u debatua dhe u formua gjerësisht opinioni në tryezën time të udhëheqjes. Kjo përfshiu një strukturë të nivelit të lartë, por më me rëndësi, vlerat dhe objektivat kyçe. E gjitha kjo u bë pa dijeninë e pjesëmarrësve për rolet që do të kishin në “botën e re”! Sigurisht, në mënyrë që të ndodhë kjo, nevojitet një nivel pjekurie i të gjithë të përfshirëve, por besoj fuqimisht se kemi një produkt më të mirë nga sa mund të imagjinoja vete dhe askush nuk ishte territorial, sepse nuk e dinin se cili ishte territori i tyre! Më në fund, vetëm pasi ishim duke vazhduar tutje në fazën e ardhshme, e caktova stafin për “nivelin 1”. Dhe faza e ardhshme ishte sjellja nivelit të ardhshëm të liderëve për tu formuar dhe përsosur më tej - me të njëjtën pasiguri personale për ta. Ky proces u përsërit për të tretën herë, gjatë së cilës u vendos struktura përfundimtare dhe u plotësua me staf.</p> <p>Megjithatë, në vazhdimësi, fakti që ndryshimi po afrohej ishte diçka e njohur publikisht! E gjithë organizata ishte e</p>

				<p>vetëdijshme për atë që po ndodhte. Ata kishin mundësi të kontribuonin dhe më e rëndësishmja të paraqesin dëshirat e tyre personale - jo se ata do të merrnin automatikisht atë që donin, por së paku dëshirat e tyre ishin në tavolinë kur merreshin vendimet. Dhe nëpërmjet gjithë kësaj, kisha nevojë që njerëzit tanë të vazhdonin të kryenin punën në këtë kohë pasigurie. Ky ishte një rrezik, por jam i gëzuar që kam rrezikuar.</p> <p>I gjithë procesi zgjati nëntë muaj ku ”të gjithë” ishin në dijeni për gjashtë prej këtyre nëntë muajve. Gjatë kësaj kohe, arritëm objektivat e biznesit. Organizata e re mbijetoi ashtu siç është planifikuar dhe brenda pak javësh po funksiononte normalisht. Unë nuk do të pretendoj se nuk kishte vështirësi, ose kjo është qasja e zgjidhjes universale për çdo ndryshim organizativ, por sigurisht që kësaj here funksionoi. Si liderë jemi gjithnjë të sfiduar që të zgjedhim “rrugën e drejtë” dhe teza ime mbetet që “rruga e drejtë” gjithmonë ndryshon.”</p>
Hapat 2-4	<i>Stuhi mendimesh</i>	<p>Studentët diskutojnë rreth problemit si grup dhe përpiqen të identifikojnë elementët kyç që përfshijnë problemin.</p> <p>Një nga studentët caktohet si moderator për të moderuar diskutimin në grup.</p>	15-20 minuta	<p>Fjalët dhe idetë kyçe të identifikuara dhe të strukturuar nga diskutimi i stuhisë së mendimeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndryshimi organizativ</li> <li>- Shqetësimet e stafit</li> <li>- Mendimet e punonjësve</li> <li>- Struktura e re</li> <li>- Rreziku</li> <li>- Sfidat rreth ndryshimit</li> <li>- Afati kohor</li> <li>- Fazat e procesit të ndryshimit</li> <li>- Zbatimi i procesit</li> </ul>
	<i>Identifikimi i nevojave kyçe të të nxënësve</i>	<p>Në sesionet e stuhive të mendimeve, studentët identifikojnë dhe rendisin temat kyçe që janë të rëndësishme dhe vendimtare për t’iu qasur problemit. Studentët gjithashtu mund të parashirojnë pyetje të</p>	15 minuta	

		<p>ndryshme lidhur me problemin dhe temat kyçe.</p> <p>Një nga studentët caktohet për të marrë shënime për temat kyçe të identifikuar.</p>		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nevoja për ndryshim</li> <li>- Diskutim dhe debat për ndryshim</li> <li>- Vlerat dhe objektivat për ndryshim</li> <li>- Stresi</li> <li>- Informacion rreth ndryshimit</li> <li>- Zgjidhja për ndryshimin</li> <li>- Propozimet dhe sugjerimet për ndryshim</li> <li>- Funksionaliteti i organizatës gjatë ndryshimit</li> <li>- Ndryshimi i vazhdueshëm</li> </ul>
	<i>Strukturimi i ideve</i>	<p>Ky hap përfshin kryesisht hartimin e një hartë të mendjes, ku studentët vendosin se cilat ide shkojnë së bashku dhe i grupojnë ato rreth pyetjeve të paracaktuara. Grupi vendos se çfarë duhet të mësohet dhe çfarë kërkon kërkime të mëtejshme.</p> <p>Një nga studentët caktohet për vizatimin e hartës së mendjes.</p>	15 minuta	
Hapi 5	<i>Formulimi i qëllimeve/objektiveve të nxënimit</i>	<p>Studentët propozojnë disa qëllime/objektiva të nxënimit për të hulumtuar dhe diskutuar burimet e literaturës. Qëllimet e nxënimit duhet të zhvillohen në drejtim të arritjes së zgjidhjeve të problemit.</p> <p>Një nga studentët caktohet për të shkruar qëllimet e nxënimit.</p>	15-20 minuta	<p><b>Qëllimet e të nxënimit</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kur dhe pse duhet të ndodhë ndryshimi organizativ?</li> <li>2. Çfarë ndikon në ndryshimin organizativ dhe cilat janë sfidat e saj?</li> <li>3. Cili është roli i kulturës dhe klimës organizative gjatë procesit të ndryshimeve organizative?</li> <li>4. Cilat janë fazat e ndryshimeve organizative?</li> </ol>
Hapi 6	<i>Të nxënimit individual dhe hulumtimi</i>	<p>Hulumtimi dhe leximi i literaturës vazhdon për disa ditë gjatë të cilave studentët mund të konsultohen me burime të ndryshme dhe të gjejnë informacione që çojnë në zgjidhjen e problemit të tyre.</p>	Disa ditë	<p><b>Literatura e udhëzuar</b></p> <p><i>Studentët duhet të lexojnë të paktën tri burime nga lista kryesore (e para me shkronja bold, obligative për të gjithë) dhe e dyta nga lista opsionale.</i></p> <p><b><u>Literatura kryesore:</u></b></p> <p>Frank J. Landy &amp; Jeffrey M. Conte. Work in the 21st</p>

			<p><b>Century: An Introduction to Industrial and Organizational Psychology. Third edition, 2010. John Wiley and Sons. Inc. Kapitulli 14.3, faqe: 658-669;</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>. Kotter's 8-Step Change Model - Implementing change powerfully and successfully;</li> <li>. Campbell, R.J. (2008). Change Management in Health Care. The Health Care Manager. Volume 27, Number 1, f. 23–39;</li> <li>. Anders, C. &amp; Cassidy, A. (2014). Effective organizational change in healthcare: Exploring the contribution of empowered users and workers. International Journal of Healthcare Management, VOL. 7 NO. 2;</li> <li>. Kettinger, W.J. &amp; Grover, V. (1995). Special Section: Toward a Theory of Business Process Change Management. Journal of Management Information Systems, Vol. 12, No. 1, f. 9-30;</li> </ul> <p><b><u>Literatura shitesë:</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Cunningham, C.E., Woodward, C.A., Shannon, H.S., Macintosh, J., Lendrum, B., Rosenbloom, D., and Judy, B. (2002). Readiness for organizational change: A longitudinal study of workplace, psychological and behavioural correlates. Journal of Occupational and Organizational Psychology, 75, 377-392;</li> <li>2. Zand, D.E., and Sorensen, R.E. (1975). Theory of Change and the Effective Use of Management Science. 532/Administrative Science Quarterly, Volume 20;</li> <li>3. Shin, J., Taylor, S.M., and Gu Seo, M. (2012). Resources for change: The relationships of organizational inducements and psychological resilience to employees' attitudes and</li> </ol>
--	--	--	---

				<p>behaviours toward organizational change. <i>Academy of Management Journal</i>, Vol. 55, No. 3, 727–748;</p> <p>4. Caldwell, D.F., Chatman, J., O’Reilly, C.A., Ormiston, M., and Lapid, M. (2008). Implementing strategic change in a health care system: The importance of leadership and change readiness. <i>Health Care Manage Rev</i>, 33(2), 124-133.</p>
<b>Hapi 7</b>	<b><i>Diskutimi dhe vlerësimi i informacionit</i></b>	<p><b>Studentët përpiqen të japin informacion dhe njohuri nga informacioni teorik dhe rastet praktike dhe të artikulojnë zgjidhje praktike për problemin. Një nga studentët caktohet si moderator për të moderuar diskutimin në grup.</b></p>	<b>90 minuta</b>	



I tërë zbatimi i procesit të PBL-së udhëhiqet dhe moderohet nga vetë studentët. Mësimdhënësi ka vetëm rolin e tutorit/mentorit, ku në shumicën e rasteve është një vëzhgues. Përveç që duhet të përfshihen në detyra në çdo hap, kërkohet edhe angazhimi shtesë nga studentët. Secilit student duhet t'i jepet rasti të përjetojë rolin e moderatorit të diskutimit në grup, qoftë në diskutimin e stuhisë së mendimeve rreth problemit apo në diskutimin e burimeve të literaturës, ose në të dyja rastet. Për më tepër, secili student duhet të përjetojë edhe rolin e marrjes së shënimeve në detyrat që lidhen me hapat 2-5. Mësimdhënësi duhet të përfshij dhe të udhëzoj burimet e literaturës, të cilat së paku janë baza për hulumtim dhe lexim për temën e lidhur me nxënien. Studentët duhet gjithashtu të inkurajohen që të hulumtojnë më tej burime shtesë të literaturës, në mënyrë që të jenë në gjendje t'i arrijnë maksimalisht qëllimet e zhvilluara të të nxënies.

### **Përgatitja**

I gjithë ky proces vjen pas një faze përgatitore të realizuar paraprakisht nga mësimdhënësi. Mësimdhënësi duhet të jetë i sigurt se rasti studimor i problemit duhet të jetë shumë relevant për temat e studimit dhe përmbajtjen e lëndës përkatës, ku PBL-ja përdoret si metodologji kryesore. Më konkretisht, mësimdhënësi duhet të sigurojë që problemet e zhvilluara dhe të përzgjedhura t'i udhëzojnë studentët për të arritur rezultatet e të nxënies të përcaktuara për lëndën. Për secilën prej temave kyçe të lëndës, mësimdhënësi duhet të përcaktojë një problem gjithëpërfshirës që përfshin të gjithë temën që duhet trajtuar për nxënie.

Përveç kësaj, mësimdhënësi mund po ashtu të përgatisë dhe të mbajë ligjërata gjithëpërfshirëse mbi konceptet teorike që lidhen me temat e lëndës të cilat shërbejnë si bazë për orientimin e studentëve drejt kornizës së të nxënies për lëndën. Ligjëratat mund të organizohen në mënyra të ndryshme, si për shembull çdo javë, pasi çdo problem të finalizohet (1-7 hapa) ose mund të organizohet çdo dy javë ose më ndryshe, varësisht si e vlerëson mësimdhënësi modalitetin më të mirë të kombinimit.

### **Vlerësimi i studentëve**

Një sërë metodash vlerësimi mund të zbatohen për vlerësimin e progresit të të nxënies të studentëve. Teknikat kyçe të vlerësimit mund të jenë, për shembull, vërtetimi individual i studentëve lidhur me angazhimin e tyre të rregullt në detyrat e procesit PBL (me cilësinë dhe sasinë e angazhimit). Për më tepër, mund të përdoret një qasje e vlerësimit 360 shkallësh, nëpërmjet së cilës inkurajohet vlerësimi kolegjial i studentëve. Mësimdhënësi mund të kryejë vlerësime përfundimtare në një formë të provimit me shkrim, i cili mund të jetë një format në formë eseje për pyetje të caktuara, ose një raport i detajuar mbi problemet e caktuara që duhet të shqyrtohen dhe/ose prezantimi i një pune të caktuar që është zhvilluar më parë. Në çdo rast, mësimdhënësi duhet të sigurohet që metodologjia e vlerësimit të jetë e përzgjedhur dhe e kombinuar në mënyrë adekuate në mënyrë që të vlerësohet progresi i studentëve drejt arritjes së rezultateve të të nxënies për lëndën.

## II. PËRGATITJA E NJË POSTERI ËSHTË DETYRE E TË NXËNIT TË BAZUAR NË PROJEKT

**Adnan Hoxha, Margriet Jaspers, Dianna Ullrich**

### **Prezantimi i metodës**

Të nxënit e bazuar në projekt u ofron studentëve mundësinë për të punuar intensivisht derisa janë duke kërkuar të përgjigjen ndaj problemeve, pyetjeve ose sfidave që kërkojnë përkushtim, janë komplekse dhe autentike. Duke bërë kështu, studentët fitojnë njohuri dhe shkathtësi të caktuara si pjesë e kompetencave specifike të përmendura më poshtë. Një shembull kur një qasje e tillë mësimore mund të përdoret është prezantimi me posterë në Modulin e Performancës në Punë, në lidhje me çështjet e ndryshme.

### **Zbatimi**

Kjo qasje zbatohet duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

Hapi 1 – Studentëve u jepet një projekt për të identifikuar profesionet kryesore që zakonisht kryhen gjatë gjithë jetës, rolin ergoterapeutik në lidhje me ato profesione dhe bazën teorike të intervenimit për fazën e caktuar të jetës.

Hapi 2 – Studentëve u caktohet të jenë në një grup-moshe për grupin që do të caktohen.

Hapi 3 – Ata duhet të vrojtojnë grupin që u është caktuar në komunitet dhe të evidentojnë profesionet e vëzhguara. Pastaj ata do të organizojnë profesionet sipas zonave të tyre përkatëse profesionale siç janë: vetë-kujdesi, koha e lirë, sociale, arsimore dhe produktiviteti.

Hapi 4 – Studentët do të organizojnë fushat që kanë identifikuar në një poster, duke përdorur artin dhe materialet artizanale dhe dizajnet kompjuterike për të bërë një prezantim vizual të gjetjeve të tyre.

Hapi 5 – Studentët do të hulumtojnë individualisht teoritë e zhvillimit që lidhen me grupin e tyre të detyrës, modelet dhe kornizat ergoterapeutike, të cilat nxjerrin në pah fokuset e profesioneve që ata kanë identifikuar dhe artikujt hulumtues, të cilët ofrojnë dëshmi për arsytimit klinike në intervenimet ergoterapeutike, specifike për grupin e tyre të detyrës.

Hapi 6 – Informatat mbi diskutimin dhe vlerësimin - Studentët prezantojnë gjetjet e tyre nëpërmjet prezantimeve të posterëve para audiencës së tyre kolegjale. Audiencës i jepet një mundësi në fund të çdo prezantimi për të parashtruar pyetje sqaruese për prezantuesin. Pas përfundimit të prezantimeve, audiencës i jepet një mundësi për të votuar se cilat prezantime ishin më efektive në rritjen e njohurive të tyre për temën.

## **Përgatitja**

Studentëve u kërkohet të kombinojnë kreativitetin me të mësuarit, ndërsa mësimdhënësit duhet të japin udhëzime dhe rregulla të qarta të cilëve duhet t'iu përmbahen të gjithë posterët. Njëkohësisht, mësimdhënësit duhet të inkurajojnë studentët e tyre që të bëjnë një poster unik në përputhje me faktorët e paracaktuar. Mësimdhënësi mund të bëjë sugjerime të ndryshme mbi atë se si duket ky poster, kështu që studentët sfidohen të përdorin kreativitetin e tyre.

## **Vlerësimi**

Ekzistojnë dy faktorë kryesorë që duhet të merren parasysh gjatë notimit: së pari përmbajtja, e cila sipas të gjitha gjasave përkon me fushën e tyre të studimit. Së bashku me përmbajtjen, duhet të përmenden referencat dhe duhet t'u referohen zhvillimeve të fundit të asaj teme; dhe së dyti, sa është tërheqës posteri dhe prezantimet e tij, në lidhje me atë nëse është interesant, i ilustruar me fotografi, i shkruar qartë, ose lehtësisht i kuptueshëm dhe i dukshëm nga distanca.

Është e këshillueshme që të kontrollohet procesi i studentëve gjatë zbatimit të këtij projekti, për të siguruar që është ofruar cilësia e kërkuar. Një shembull mund të jetë që studentëve t'u kërkohet ta dorëzojnë disa javë para se ata të bëjnë prezantimin e posterit të tyre ose t'u jepet një listë e literaturës që mund të përdorin. Kjo parandalon situatat ku ata bazohen në literaturë të vjetër ose të parëndësishme dhe siguron përdorimin e disa burimeve, në vend të vetëm një ose dy burimeve.

Për më tepër, studentët vlerësohen për kompetencat e përgjithshme dhe profesionale të mëposhtme:

- 1) Pamja dhe përmbajtja e posterit
  - a. Tërheqje vizuale
  - b. Rëndësia e informacionit dhe pjesa vizuale
  - c. Përshtatshmëria e përmbajtjes
  - d. Stili i referencave
- 2) Aftësitë prezantuese
  - a. Rrjedhshmëria komunikuese
  - b. Referimi në poster gjatë prezantimit
  - c. Qëndrim në raport me posterin dhe audiencën
  - d. Kontakti me sy me audiencën
  - e. Ritmi i fjalimit
  - f. Dëgjimi i pyetjeve
  - g. Menaxhimi i kohës
  - h. Profesionalizmi
- 3) Njohja e temës
  - a. Njohuria e shprehur

b. Aftësi për t'iu përgjigjur pyetjeve të audiencës

Rrjedhimisht, pritet që studentët të përfitojnë kompetencat e mëposhtme:

- 1) Kompetencat e përgjithshme
  - a. Bashkëpunimi kolegjial
  - b. Shkathësitë hulumtuuese
  - c. Menaxhimi i kohës
  - d. Mendimi kritik
  - e. Reflektimi
  - f. Kreativiteti
  
- 2) Kompetencat specifike të profesionit
  - a. Zhvillimi i njohurive mbi profesionin dhe praktikën ergoterapeutike
  - b. Shpjegimi i konstrukteve teorike
  - c. Angazhimi dhe ndikimi i të tjerëve në debatet lidhur me profesionin
  - d. Përdorimi i arsytimit profesional dhe etik
  - e. Bashkëpunimi me komunitetet
  - f. Vlerësimi kritik i informacionit në lidhje me ergoterapinë
  - g. Vlerësimi dhe respektimi i dallimeve individuale
  - h. Demonstrimi i besimit në vetë-menaxhim

### III. BASHKË-KRIJIMI


**Jennifer Cardwell**

#### **Hyrje në strategjinë bashkë-krijuese të të nxënit**

Studentët si partnerë, agjentë të ndryshimit, krijues dhe bashkë-krijues të të nxënit të tyre janë temë e interesimit në rritje gjatë viteve të fundit (Bovill et al., 2011; Dunne dhe Zandstra, 2011).

Në kuadër të shumicës së universiteteve, vendimmarrja në mësimdhënie dhe mësim-nxënie është në përgjithësi fushë e stafit akademik dhe shpesh studentët nuk pyeten (Mann, 2008). Puna e kohëve të fundit lidhur me bashkë-krijimin e mësim-nxënies dhe mësimdhënies sfidon këto norma/praktika tradicionale në lidhje me rolet "akademike" dhe "studentore" brenda arsimit të lartë dhe mbështet një demokratizim më të madh të procesit arsimor. Bashkë-krijimi ndodh kur mësimdhënësit dhe studentët punojnë së bashku për të krijuar kurrikulën, rezultatet, stilet/rezultatet e mësim-nxënies dhe mësimdhënies dhe pastaj të identifikojnë vlerësimet e duhura - studentët janë aktivë në të gjithë procesin dhe jo vetëm pranues të informacionit, por plotësisht të përfshirë në të gjithë procesin e të mësuarit nga fillimi deri në fund.

#### **Rolet e bashkë-krijimit të studentëve përfshijnë:**



## Zbatimi

Bashkë-krijimi mund të marrë forma të ndryshme në disiplina dhe institucione të ndryshme. Stafi dhe studentët mund të bashkëpunojnë për: vlerësimin e përmbajtjes së lëndës si dhe proceseve të mësim-nxënies dhe mësimdhënies; (ri) dizajnimi i përmbajtjes së lëndëve; të nxënit dhe të mësuarit hulumtues; realizimi i hulumtimit disiplinor; vlerësimet e dizajnit të tilla si pyetjet e eseve ose përzgjedhja mes metodave të ndryshme të vlerësimit; dhe notimi i punës së tyre dhe të të tjerëve. Po kështu, bashkë-krijimi mund të ndodhë në shkallë të ndryshme, duke përfshirë: iniciativat individuale, në klasë dhe në lëndë deri në nivelin institucional duke adresuar qëllimet pedagogjike, operacionale dhe strategjike. Në secilin prej këtyre niveleve, bashkë-krijimi sfidon normat e arsimit në mënyra të ndryshme (Cook-Sather et al., 2014). Ekzistojnë sfida në zbatimin e arsimit bashkë-krijues të cilat zakonisht identifikohen nga stafi dhe pjesëmarrësit nga ana e studentëve dhe ndahen në tri tema komplekse dhe të ndërlidhura: rezistenca ndaj bashkë-krijimit të mësim-nxënies dhe mësimdhënies; shfletimi i strukturave, praktikave dhe normave institucionale; dhe krijimi i një qasjeje gjithëpërfshirëse.

## Përgatitja

Një mjedis virtual i të nxënit siç është Moodle shpesh perceptohet si një medium i komunikimit të njëanshëm, por mund të jetë thelbësor në përgatitjen e aktiviteteve të të nxënit të bashkë-krijimit, duke lejuar qasje në burime, forume diskutimi, platforma Wiki, informata kthyesë etj., ku studentët dhe stafi ndër-veprojnë, që nuk kufizohet nga afatet kohore të përcaktuara dhe pjesëmarrja në vend.

## Detyra: Rishikimi i modulit të vitit të parë të programit nga studentët e vitit të tretë

Hapat	Aktivitetet	Koha	Shembuj që tregojnë përdorimin e bashkë-krijimit
1.	Hapi i parë është të identifikohet se kë e doni në seancën tuaj të bashkë-krijimit. Ndoshta janë ca njerëz që i keni intervistuar tashmë. Ndoshta është një demografi e veçantë si	15 minuta	Studentët e vitit të tretë të programit të ftuar për t'iu bashkangjitur grupit për të vlerësuar dhe riformuluar një modul të identifikuar - maksimumi

	adoleshentët ose fermerët femra apo njerëzit e papunë.		12 studentë
2.	Filloni –Përmbledhje Qartë deklaroni qëllimin dhe objektivin e ngjarjes dhe pastaj përcaktoni kornizën për pjesëmarrje. Përshkruajeni objektivin arsimor dhe pastaj kërkoni kontribute për atë se për çfarë dëshironi të merrni opinione.	30 minuta	Përshkruani projektin, pyetini studentët se si mund t'i qasen projektit, për cilat burime kanë nevojë, çfarë është në dispozicion, p.sh. salla, TI, stafi, biblioteka etj.
3.	Inspironi pjesëmarrjen Lehtësojeni pjesëmarrjen dhe shpjegoni përfitimet e kontributit për të nxënëit dhe metodat që përdoren.	20 minuta	Përshkruani se cilat do të jenë përfitimet e të nxënëit për studentët
4	Fillimi Përfitoni maksimalisht nga një sesion i bashkë-krijimit me teknika për <u>Fillimin e Bisedës, Stuhi Mendimesh, Lojë me Role</u> ose aktivitete tjera për të angazhuar grupin tuaj rreth problemit që doni të zgjidhni.	60 minuta Kjo mund të përsëritet sipas nevojës	Studentët ndahen në grupe të vogla për të punuar së bashku, duke vendosur për detyrat dhe ndarjen e tyre brenda grupit - stuhia e mendimeve, ndarja e punës, leximi, kush do të intervistojë studentët dhe/ose stafin.
5	Zhvillimi i idesë, kopjimi dhe dizajni Grupi vendos për fushat e ndryshme të hulumtimit/të të nxënëit	60 minuta Kjo mund të përsëritet sipas nevojës	Grupi punon së bashku duke përdorur aftësitë për zgjidhjen e problemeve, aftësinë për të bashkëpunuar, për të marrë informata kthyesë dhe t'iu përgjigjet në mënyrë konstruktive informacioneve të marra deri tani. Një anëtar i stafit mund të sjellë ekspertizën dhe njohuritë e veta tek grupet, si një anëtar aktiv i barabartë i grupit.
6	Rishikimi dhe përmirësimi Grupi shqyrton punën deri më	30 minuta	Studentët përsosin rezultatit e tyre në

	<b>sot dhe përpunon detajet, duke ri-shkruar përmbajtjen.</b>		<b>grupet e diskutimit.</b>
<b>7</b>	<b>Prezantimi Përmbledhja e procesit të të nxënit/zhvillimit deri më sot</b>	<b>60 minuta</b>	<b>Studentët paraqesin rezultatet e projektit (moduli i ri) për stafin dhe studentët e tjerë që kërkojnë informata kthyesë</b>
<b>8</b>	<b>Finalizimi Shqyrtimi i të nxënit bazuar në informata kthyesë</b>	<b>30 minuta</b>	<b>Beni përshtatjet sipas detajeve të modulit bazuar në informatat kthyesë</b>
<b>9</b>	<b>Përfundimi dhe identifikimi i të nxënit Të nxënit/zhvillimi përfundimtar dhe identifikimi i asaj që është nxënë nga projekti/aktivitetet e ndërmarra</b>	<b>60 minuta</b>	<b>Studentët identifikojnë atë që kanë nxënë nga përfshirja në projekt - p.sh. shkathtësitë dhe njohuritë e fituara.</b>

### **Vlerësimi i studentëve**

Brenda një mjedisi(real) të bashkë-krijimit, studentët duhet të inkurajohen që të bashkë-krijojnë vlerësimet e tyre në bazë të kompetencave dhe/ose rezultateve të të nxënit. Studentët dhe stafi që punojnë në grupet e bashkë-krijimit mund të diskutojnë dhe krijojnë mjetet aktuale të vlerësimit, siç janë:

1. Detyrat e seminarit dhe kontributi për të punuar në bashkë-krijim (vlerësimi kolegjial)
2. Një prezantim në grup (15min)
3. Një raport individual me shkrim që identifikon të nxënit (1,500 fjalë)
4. Një portfolio elektronike individuale që regjistron aktivitetet në të cilat janë angazhuar studentët individual (2,500 fjalë)

Studentët dhe stafi zhvillojnë kriteret e shënimit bazuar në mjetet dhe kompetencat/rezultatet e të nxënit. Ata gjithashtu do të përcaktojnë kriteret e linjës referuese për dështimin, nivelin e kalueshmërisë, për nivelin e meritës dhe për punën e nivelit të dallimit; e gjithë kjo është rënë dakord brenda grupeve të bashkë-krijimit të studentëve dhe stafit që diskutojnë dhe shqyrtojnë së bashku derisa të arrihet marrëveshja.



## IV. NXËNIA E BAZUAR NË SIMULIME

### **Prezantimi i metodës:**

Nxënia e bazuar në simulime mund të sjellë përgjigje në krijimin e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve të ekspertëve shëndetësorë, duke mbrojtur pacientët nga rreziqet që janë të panevojshme. Strategjia e bazuar në simulime në aspektin e kujdesit shëndetësor mund të jetë një fazë për të vëzhguar se si të lehtësohen presionet etike dhe të zgjidhen vështirësitë pragmatike (Mims, 2004). Metodatat, aparatet dhe procedurat e përgatitjes të bazuara në simulim mund të lidhen në planifikimin e takimeve të organizuara të të nxënimit dhe të shfrytëzohen si një instrument vlerësimi i lidhur me aftësitë e fokusuara të bashkëpunimit dhe objektivat e të nxënimit (Goeree, 2011). Kjo ishte e lidhur gjerësisht në biznesin e avionikës, anesteziologjisë dhe në ushtri. Zvogëlon gabimet dhe siguron një kulturë të mirëqenies.

Kompetencat që studentët fitojnë pas kryerjes së një aktiviteti simulimi janë: njohuritë, praktikimi i shkathtësive, të menduarit kritik dhe vetëbesimi.

### **Zbatimi:**

#### **Hapi 1.** Përshkruani shkurtimisht skenarin

Mësimdhënësi duhet të japë një pasqyrë të shkurtër të skenarit që përfshin profilin dhe historinë e pacientit dhe profesionistët shëndetësorë që duhet të përfshihen në kujdesin e klientit.

#### **Hapi 2.** Identifikimi i studentëve të synuar.-

Për të arritur rezultate pozitive, mësimdhënësi duhet të marrë parasysh nëse kandidatët janë staf, student ose anëtarë të një ose më shumë disiplinave të ndryshme.

#### **Hapi 3.** Zhvilloni një përshkrim të skenarit

Zhvilloni një përmbledhje më të gjerë të studimit të skenarit i cili dallon parametrat e veçantë të pacientit dhe shkathtësitë që priten nga ekspert të kujdesit shëndetësor të përfshirë në kujdesin e pacientit. Mendoni të përdorni një skenar të rastit real në vend se ta krijoni atë vetë.

#### **Hapi 4.** Dizajni i aktivitetit të trajnimit.-

Gjatë hartimit të një skenari të simulimit të trajnimit, duhet të zbatohet një skriptë dhe një dizajn i një aktiviteti të tillë. Situata duhet të pasqyrohet në mënyrë të qartë.

Veprimet që duhet të ndërmerren në këtë pjesë:

- Identifikimi i profileve të studentëve dhe nevojave të tyre
- Identifikimi i kompetencave që duhet të trajnohen
- Përcaktimi i objektivave të sakta për aktivitetin e trajnimit
- Identifikimi i komponentëve udhëzues që përshkruajnë praktikën dhe skenarin e qëllimshëm.
- Përcaktoni qasjen e vlerësimit për rezultatet e aktivitetit të të nxënit.

#### **Hapi 5.** Ndarja e studentëve në grupe

Kohëve të fundit, ekipi i kujdesit shëndetësor dhe mësimi grupor njihen si një nga objektivat më të rëndësishme që duhet të arrihen në kornizën arsimore të profesionistëve të ardhshëm të kujdesit shëndetësor. Studentët duhet të ndahen në 4 grupe me 5 studentë në secilin grup.

#### **Hapi 6.** Zgjidh metodat e mësim-nxënies/mësimdhënies

Aktivitetet e të nxënit të bazuara në simulim mund të inkorporojnë cilëndo nga llojet e mëposhtme:

- Prezantimin në Power Point
- Skenarët e rasteve
- Raportimi dhe informatat kthyesë
- Videot e shkurtra
- Videoklipet në internet
- Vlerësimi

- Diskutimet në grupe
- Ligjëratat ballë për ballë

**Hapi 7.** Vendosni pajisjen dhe llojin e aktivitetit të simulimit.

Kur një mësues është gati për të zbatuar ndonjë aktivitet simulimi, ai/ajo mund të përfshijë: trajnerët e një pjese të detyrës së caktuar (p.sh. krahu ose legeni), sistemet kompjuterike, simulatorin e integruar, klientët e simuluar, nxënësin ndër-profesionale, lojën me role dhe skenarët e bazuar në letër.

Është e rëndësishme për mësuesin dhe studentët që të njihen me pajisjet që janë duke u përdorur për të garantuar sigurinë gjatë zbatimit të ndonjë aktiviteti simulimi.

**Hapi 8.** Organizoni një plan të mësimit/mësimit-nxënies

<b>KOHËZGJATJA</b>	<b>TEMA</b>	<b>TEKNIKA E AKTIVITETIT</b>
<b>30 minuta</b>		<b>Videoklipet në internet</b>
<b>45 minuta</b>		<b>Ligjëratat ballë për ballë</b>
<b>15 minuta</b>	<b>Pushim</b>	
<b>90 minuta</b>		<b>Stacioni i seancës/shkathësive praktike me trajner të një pjese të detyrës së caktuar</b>
<b>45 minuta</b>	<b>Pushim</b>	
<b>15 minuta</b>	<b>Informata kthyesë dhe diskutimet e hapura</b>	

**Hapi 9.** Jepuni studentëve udhëzime të detajuara

Mësuesi duhet të përshkruajë shkurtimisht atë që ai/ajo dëshiron që studentët të bëjnë. Si një udhëzim i rëndësishëm mund të jetë, për shembull, t'u kërkohet studentëve të nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes.

## **Hapi 9.** Zbatimi i planit mësimor

### **Përgatitja:**

Mësimdhënësi mund të zbatojë skenarë duke përdorur pacientë të standardizuar, simulatore bazikë ose simulatore të avancuar që mund të ofrojnë një reagim më të mirë dhe të lejojnë studentët të manipulojnë variabla dhe parametra të ndryshëm me skenarin. Do të ishte shumë e vështirë nëse mësimdhënësi/instruktori nuk do të ishte në gjendje të mbështetet në mediat audio-vizuale ose të mos kishte fare qasje në to. Mësimdhënësi duhet të ketë eksperiencë të nivelit të lartë në shfrytëzimin e simulatorëve, si dhe sistemeve të regjistrimit në mënyrë që ai/ajo të mund të përqendrohet në aktivitetin kryesor të një skenari të tillë (Cross, Spencer, & Hills, 2014). Nëse mësimdhënësi nuk ka përvojë, duhet të ketë së paku personel që mund t'i ndihmojë mësimdhënësit në këto përpjekje. Në kryerjen e një aktiviteti të tillë, një ndikim i madh mund të pritët nga kushtet e domosdoshme siç janë dhomat klinike ose sallat e operimit. Mjedisi fizik është një faktor vendimtar që mund të ndihmojë në përmirësimin e intensitetit dhe realizimit të skenarit.

Në punën përgatitore të mësimdhënësit, ajo nuk duhet të konsiderohet si diçka e rëndësishë së vogël. Është përgjegjësia kryesore të sigurohet që çdo simulator është duke u përdorur në skenar dhe sistemi i regjistrimit punon siç duhet (Turan, 2015). Duhet gjithashtu të vërtetohet se ka lidhje të mjaftueshme në dhomë dhe se të gjitha materialet shpenzuese të nevojshme për realizimin e skenarëve siç janë dorezat, maskat, shiringat, maskat pompuese të ajrit, janë në sasi të mjaftueshme. Varësisht prej zhvillimit të skenarit dhe pjesëmarrjes së grupit, do të ishte interesante përfshirja e problemeve që detyrojnë ose rezultojnë në ndryshim të udhëheqjes në mënyrë që të rritet pjesëmarrja e studentëve në role tjera (Gallagher & O'Sullivan, 2012). Është shumë e rëndësishme që studentët të fitojnë aftësinë e mendimit kritik gjatë zbatimit të një aktiviteti simulimi.

### **Vlerësimi**

Pas kryerjes së aktivitetit të simulimit, është koha për të bërë vlerësimin e studentëve dhe rezultateve të një aktiviteti të tillë duke përdorur regjistrimin e aktivitetit që është bërë për qëllime të prezantimit. Një tipar i rëndësishëm i strategjisë së të nxëniet të bazuar në simulim

gjatë vlerësimit të studentëve, është vetë-vlerësimi i tyre si dhe kritikën lidhur me performancën e të tjerëve dhe mësimdhënësve. Skenarët u lejojnë mësimdhënësve të vlerësojnë studentët sa u përket shkathtësive të tyre personale, siç janë, stili i komunikimit, iniciativat e udhëheqjes, aktivitetet ndër personale, sjelljet etike (Granado & Riley, 2013). Mësimdhënësi, para aktivitetit, duhet gjithmonë t'i tregojë studentit se cilat kompetenca do të vlerësohen. Vlerësimi duhet gjithashtu të bazohet në një kornizë të ndryshme nga ajo e vlerësimit tradicional. Mësimdhënësi duhet gjithashtu të vlerësojë performancën e tij ose të saj dhe çdo gjë që ka ndikuar në zhvillimin, nivelin e bashkëpunimit që është arritur si dhe objektivat që nuk janë arritur gjatë një aktiviteti të tillë (Zunzarren & Rodriguez-Sedano, 2011). Edukatorët do të arrijnë progres në të qenurit ndihmës dhe të njëjtit do t'i ndihmojnë studentët në rast se ata vlerësojnë performancën e tyre dhe pyesin veten se si mund të zhvillohen si ndihmës.

## **2. Nxënia e kombinuar – Shaban Buza, Idriz Berisha, Skender ??**

Nxënia e kombinuar paraqet formën e metodologjisë së mësimdhënies që kombinon mediat digjitale me metodat tradicionale të bazuara në klasë. Kjo metodë u mundëson mësimdhënësve dhe studentëve të:

- integrojnë qasjen teorike me atë praktike;
- mësojnë duke parë.

Për aplikimin e të nxënies të kombinuar në procesin mësimor, seanca mësimore do të ndahet në katër faza të ndryshme:

- Faza e parë – ligjëratat përmes internetit (e regjistruar nga tema e fundit) do t'u prezantohet studentëve. Ky material përfshin gjërat më të rëndësishme të mësuara në ligjëratën e fundit dhe u mundëson studentëve të kujtojnë çështjet më të rëndësishme të mësuara.
- Faza e dytë – mësimi i rregullt i temës së re (e cila gjithashtu do të regjistrohet për seancën e ardhshme të të mësuarit). Kjo është pjesa ku mësimdhënësit aplikojnë metodën e tij/saj.

- Faza e tretë – prezantimi i videove të kushteve, problemeve, çështjeve, përvojave personale të ndryshme etj. në procesin mësimor. Kjo formë u mundëson mësimdhënësve të përshkruajë temën e interesit, ndërsa studentëve të përfitojnë problemin/kontestin/çështjen.
- Faza e katërt - bëhet një vlerësim i thjeshtë përmes internetit mbi njohuritë e fituara.

Ky format do të sigurojë një kalim të vazhdueshëm nga një temë në tjetrën dhe gjithashtu ligjëratat përmes internetit do të shërbejnë për përgatitjen e provimit përfundimtar.

## V. NXËNIA E BAZUAR NË HULUMTIM

### Arben Boshnjaku, Kushtrim Grezda

Studentët ndahen në grupe të vogla të punës. Çdo të dytit grup i caktohet një detyrë specifike.

Detyrat kanë të bëjnë me ekzistencën e trupit hulumtues lidhur me një problem brenda procesit të rehabilitimit social (p.sh. rehabilitimi social në Kosovë, integrimi përmes rehabilitimit social, rehabilitimi social i të moshuarve, etj.).

Bazuar në fjalët kyçe të përcaktuara nga detyra e caktuar (p.sh. sociale, rehabilitimi dhe Kosova), studentët do të duhet të gjejnë informacione të publikuara.

Ky proces "hulumtues" do të zgjasë për 30 minuta dhe në ndërkohë mësimdhënësit do të lëvizin mes grupeve për t'i mbikëqyrur, për t'u ofruar ndihmë dhe përgjigje për çdo pyetje të mundshme.

Studentët inkurajohen të përdorin bazat e të dhënave online, dokumentet publike, punimet dhe disertacionet, bibliotekat elektronike dhe ato të rregullta si dhe të gjitha burimet tjera potenciale. Përveç burimeve tjera, ne sugjerojmë të përdoren:

- Scopus;
- Webofscience;
- Pubmed/Medline;
- EBSCO;
- WorldCat;
- DOAJ;
- Googlescholar;

Studentët mund të punojnë në klasë ose nëse e kanë më të lehtë ata mund të punojnë në bibliotekë.

Qëllimet e kësaj strategjie janë:

- të nxjerrë në pah vlerën e hulumtimit për të nxënësit e studentëve;
- të nxjerrë në pah potencialin e hulumtimit në strategjitë e mësimimit;
- të fusë hulumtimin si metodologji e të nxënësit;
- të përfshijë të gjithë në procesin e të nxënësit;
- të përmirësojë mendimin kritik me anë të hulumtimit;
- të përmirësojë zgjidhjen e problemeve përmes hulumtimit;
- të nxjerrë në pah rëndësinë e punës ekipore.

Secila detyrë u jepet dy grupeve njëkohësisht, me qëllim që studentët (nga të dy grupet) të kenë mundësinë të diskutojnë dhe të arrijnë në përfundime reciproke në lidhje me gjetjet e tyre më pas.

Pasi të përfundojnë 30 minutat e "hulumtimit", secili grup paraqet (me radhë) gjetjet e tyre.

Prezantimi zgjat deri në 10 minuta, ndërsa 5 minuta shtesë janë të rezervuara për pyetjet e grupit tjetër (apo edhe të studentëve tjerë nëse kanë ndonjë pyetje).

Së fundi, të dy grupet (me të njëjtën temë) mblidhen së bashku dhe përgatisin një sërë përfundimesh lidhur me temën e tyre (maksimumi 10 minuta). Këto përfundime duhet të jenë sa më gjithëpërfshirëse që të jetë e mundur dhe duhet të shërbejnë si një "mesazh që mbahet mend".

Në fund duhet bërë një prezantim përfundimtar prej 5 minutash i këtyre përfundimeve dhe një reflektim me të gjitha grupet së bashku.

## VI. LEHTËSIMI I TË NXËNIT (MBIKËQYRJA DHE TRAJNIMI)

**Dianna Ullrich, Jennifer Caldwell, Kushtrim Veliu**

### **Hyrje**

Për të mësuar në mënyrë efektive, studenti duhet të përjetojë informata konkrete, vrojtim reflektues, konceptualizim abstrakt dhe eksperimentim aktiv (Matsuo, 2015). Roli i trajnerit ose mbikëqyrësit është të lehtësojë procesin e të nxënimit në secilën nga këto fusha. Trajneri mund të jetë prezent personalisht në klasë ose prezenca e tij mund të sigurohet në mënyrë digjitale, duke përçuar informata që do të përforcojnë të nxënimit teorik dhe praktik (Leung, Critchley, Yung, et al., 2015). Megjithatë, në një mjedis klasor, një trajner i suksesshëm i cili lehtëson të nxënimit i përshtat sjelljet e tij/saj për të përmbushur kërkesat e mjedisit mësimor (Nash, Sproule & Horton, 2011). Trajneri gjithashtu stimulon të menduarit kritik dhe aftësitë klinike logjike. Një mbikëqyrës përdor njohuritë dhe aftësitë e tij klinike për krijimin e një mjedisi mbështetës të të nxënimit që inkurajon pjesëmarrjen aktive nga të gjithë anëtarët dhe vazhdimisht monitoron cilësinë e të nxënimit (Wang, Li & Pang, 2016). Në thelb, si trajneri i cili lehtëson të nxënimit, ashtu edhe mbikëqyrësi ofron të njëjtin tip të mjedisit mësimor. Si trajneri ashtu edhe mbikëqyrësi mbledhin nga burimet e studentëve dhe i inkurajojnë ata që të gjejnë zgjidhjet e tyre. Prandaj, të dy emrat mund të përdoren në mënyrë të ndërsjellë për të përshkruar lehtësuesin e të nxënimit. Këtu e tutje do të përdoret termi "Lehtësues".


Lehtësuesi zhvillon kompetencat e studentëve nëpërmjet modelimit, ofrimit të strukturës mbështetëse, mentorimit, strukturimit të detyrave dhe ofrimit të sugjerimeve, pa dhënë në mënyrë eksplicite përgjigjet përfundimtare (Wang, Li & Pang, 2016). Me fitimin e njohurive



dhe përvojës nga ana e studentëve ndikimi i lehtësuesit fillon të zbehet. Lehtësuesi përdor ekspertizën e tyre për të modeluar zbatimin praktik të teorisë së të nxënës në një kontekst real ose të simuluar. Lehtësuesi demonstroi metoda ose teknika praktike dhe studentët përsërisin atë që kanë vërejtur. Duhet të krijohet një besim ndërmjet studentit dhe lehtësuesit. Ky besim quhet ofrim i strukturës mbështetëse dhe mund të konsiderohet i njëjtë si “përdorimi terapeutik i vetvetes” që zbatohet nga mjekët me pacientët ose klientët e tyre. I njëjti koncept përdoret për të ndërtuar besimin midis studentit dhe mësuesit ose lehtësuesit. Ofrimi i strukturës mbështetëse emocionale ndërton një raport dhe besim dhe mban një marrëdhënie të mirë ndërmjet studentit dhe lehtësuesit i cili inkurajon motivimin për të mësuar. Lehtësuesi përdor mentorimin si një mjet për të monitoruar ecurinë e të nxënës tek studentët duke u ofruar atyre mjete për të udhëhequr përvojën e tyre. Studentët marrin atë që kanë mësuar dhe lehtësuesi siguron një sërë skenarësh ose mjedisesh ku mund të aplikohen shkathtësitë praktike. Studentët tani më nuk mësojnë përmes mentorimit, por atyre u ofrohen më shumë mundësi për të demonstruar atë që kanë mësuar. Mentori i ofron këto mundësi. Lehtësuesi gjithashtu strukturon detyrat në mënyrë që studenti ta ketë të qartë se cilat janë detyrat e tij. Siç ndodh në çdo zbatim praktik, studentët vendosen në një mjedis ku ata mund të demonstrojnë shkathtësitë e tyre si mjekë, megjithatë, është lehtësuesi i praktikës ai i cili u shpjegon atyre se cilat praktika dhe kompetenca duhet të arrijnë ose demonstrojnë deri në fund të aplikimit të praktikës. Studentëve u jepen sugjerime nga ana e lehtësuesit për të treguar nëse ata janë në rrugën e duhur apo jo sa i përket asaj që duhet të mësojnë. Sugjerimet mund të jenë në formën e pyetjeve të thjeshta që ose do të afirmojnë apo ri-orientojnë veprimet e një studenti. Për shembull, “Si t’u duk kjo?” ose “Si ishte kjo për klientin?”

## **Implementimi**

Hapat e modelimit përmes dhënies së përparësisë mund të jenë një strategji progresive e mësimit për mësuesin lehtësues. Më poshtë kemi një paraqitje vizuale të kalimit të përgjegjësisë në procesin mësimor nga ndërmjetësi te studenti. Më pas vijon një shembull praktik i një rasti studimor.



Shembull:

Gjatë modulit të Teknologjisë Përshtatëse, objektivi është që studentët të mësojnë se si të përshtatin një karrocë në mënyrë specifike për një klient.

Hapi 1: Ofrimi i sistemit mbështetës

- A. Mësimdhënësi shpjegon sfondin e ndërhyrjes dhe si ndërlidhet me profesionin
- B. Mësimdhënësi pyet studentët se a kanë qenë ndonjë herë në karrocë ose a e njohin dikë në karrocë. Mësimdhënësi u kërkon studentëve të ndajnë përvojat e tyre, derisa mësimdhënësi dëgjon dhe afirmon komentet që lidhen me perceptimin e përdoruesve sa i përket karrocave.
- C. Mësimdhënësi tregon anekdota nga praktika personale me qëllim që t'i bëjë studentët të ndihen rehat dhe të kenë besim në kompetencat e mësimdhënësit.
- D. Mësimdhënësi shpjegon teorinë mbi adaptimin e karrocave

Hapi 2: Modelimi

- A. Mësimdhënësi ofron të gjitha furnizimet dhe pajisjet e nevojshme për të bërë një ulëse të karrocës dhe pjesët mbështetëse, si dhe materialet lidhëse.
- B. Mësimdhënësi përdor një student që është më i hollë se gjerësia e karrocës për ta përdorur si model dhe demonstroi teknikat e matjes, si dhe e përshtat karrigen dhe mbështetëset dhe fut rripat e duhur në hapa të ndryshëm derisa studentët vëzhgojnë.
- C. Mësimdhënësi ndalet në mes të hapave për t'u mundësuar studentëve të bëjnë matjet dhe të bëjnë vetë gjërat derisa mësimdhënësi vëzhgon.

Hapi 3: Mentorimi

- A. Mësimdhënësi sjell një klient ose organizon studentët në grupet për të përdorur njëri-tjetrin si klientë, ose studentët vendosen në një mjedis praktike ku behet përshtatja e karrocave.
- B. Mësimdhënësi inkurajon studentët se si të gjejnë materialet e nevojshme dhe të realizojnë çdo hap të procesit.

- C. Mësimdhënësi vlerëson dhe jep këshilla derisa studentët vazhdojnë punën mbi projektet e tyre.

#### Hapi 4: Detyrat e strukturuar

- A. Mësimdhënësi informon studentët për kompetencat e të nxënit që ata duhet të fitojnë nga përvoja e përshtatjes së karrocave. Për shembull; intervista me klientin, “përdorimi terapeutik i vetvetes”, puna me kolegët, shkathtësia për të përdorur mjete, përdorimi i shkathtësive për zgjidhjen e problemeve, menaxhimi i kohës, etj.
- B. Studentët marrin iniciativë për të marrë furnizime dhe për të vazhduar me çdo hap të procesit të adaptimit të karrocave në mënyrë të pavarur.
- C. Mësimdhënësi vëzhgon dhe jep reagime lidhur me progresin,

#### Hapi 5: Përgjigja me radhe

- A. Gjatë praktikës, mësimdhënësi përdor gjeste dore ose fraza verbale si sugjerime për të paralajmëruar nevojën për përshtatje të sjelljes së studentit ose për të afirmuar sjelljet e studentit.
- B. Pas përfundimit të projektit, mësimdhënësi u ofron studentëve mundësi për të reflektuar mbi punën e tyre.
- C. Studentët diskutojnë përvojat e tyre si një grup në një mjedis klasor derisa mësimdhënësi i dëgjon ata.
- D. Mësimdhënësi përdor pyetje për të inkurajuar vetëvlerësimin e studentëve

## **Përgatitja**

Përgatitja për ofrimin e një mjedisi lehtësues të të nxënimit kërkon shqyrtimin e estetikës së mjedisit të të nxënimit. Klasa duhet të jetë në një hapësirë të hapur ku ka hapësirë të mjaftueshme për mësimdhënësin që t'i qaset çdo studenti në një distancë të afërt. Preferohet që të ketë tryeza të rrumbullakëta ku studentët organizohen në grupe me jo më shumë se 8 persona për secilën tryezë. Karriget duhet të jenë të lehta në peshë dhe të lehta për t'u lëvizur. Tavolinat dhe karriget duhet të vendosen në mënyrë të tillë që studentët dhe mësimdhënësit të lëvizin në klasë pa pengesa. Klasa duhet të ketë tabela të bardha dhe flip chart në dispozicion për studentët që të jenë në gjendje të shkruajnë idetë dhe mësimdhënësit të mund të japin një pasqyrë të teorisë. Duhet të ketë qasje në posterë të mëdhenj dhe markerë për seanca të stuhive të mendimit.

Akustika në dhomë duhet të jetë e tillë që studentët të jenë në gjendje ta dëgjojnë njëri-tjetrin gjatë diskutimeve në grup dhe mësimdhënësi të jetë në gjendje të dëgjojë studentët pa pasur probleme me jehonë të zërit dhe humbje të tij. Temperatura e dhomës duhet të jetë e përshtatshme, në mënyrë që të mos pengojë vëmendjen e studentëve ose t'i detyrojë ata t'i hapin dritaret, gjë që do të shkaktonte humbje të theksuar të vëmendjes. Studentët duhet të jenë të lirë të postojnë ose shfaqin aktivitetet në klasë, pa frikë se puna e tyre do të shkatërrohet ose do të vidhet nga grupe tjera të studentëve. Mjedisi i klasës duhet të paraqesë një atmosferë të pronësisë nga ana e studentëve, ku ata ndihen rehat dhe të respektuar si studentë. Mjedisi duhet të jetë i përshtatur për studentët.

Krijimi i një mjedisi të shëndoshë për mësim përfshin gjithashtu përgjegjësinë e mësimdhënësit për të ushtruar teknika të duhura për menaxhimin e kohës dhe stresit. Ata duhet të përpiqen të mbajnë një ekuilibër mes punës, pushimit dhe aktiviteteve shoqërore. Ata duhet të përpiqen të mbrojnë shëndetin e tyre dhe të krijojnë shprehi të mira të gjumit. Ata duhet të dinë kufijtë e tyre në lidhje me kohën në dispozicion, si dhe shkathtësitë. Ata duhet t'u delegojnë të tjerëve aktivitete të cilat do të bënin që ata të jenë të përgatitur për orët e mësimin. Ata duhet të mësohen si të thonë "jo" në kohë të përshtatshme, në mënyrë që të mbrojnë kohën që u nevojitet me studentët e tyre. Nëse mësimdhënësit janë nën stres shumë të madh personal

ose profesional, ata nuk do të jenë në pozitë të mirë për të lehtësuar një përvojë funksionale të të nxënit për studentët.

### **Metodat e vlerësimit të studentëve**

Mund të përdoren një sërë metodash vlerësimi të cilat mund të jenë në formë të shkruar ose në formë të demonstrimit praktik. Mësimdhënia ose të nxënit lehtësues nuk shfrytëzon provime me shkrim me përgjigje të shkurtra. Provimet me shkrim duhet të jenë të hapura si në formën e rasteve studimore. Pyetjet e provimeve duhet të fillojnë me: si, çfarë, ku, kur dhe pse, shpjegoni, listoni, demonstroi ose tregoni, vizatoni, etj..... Provimet me shkrim mund të jenë në formën e eseve, ku studentët mund të demonstrojnë gjerësisht njohuritë e tyre lidhur me një temë specifike. Një tjetër metodë e vlerësimit mund të jetë përmes vëzhgimit të detyrës ose vlerësimit të cilësisë së punës së projektit, siç është shembulli i adaptimit të karrocave. Vlerësimet mund të përfshijnë angazhimin në diskutimin në klasë, pjesëmarrjen, sjelljen profesionale me kolegët, klientët, stafin e vendit të praktikës dhe me mësimdhënësit. Vlerësimi mund të përfshijë respektimin e kodeve profesionale të etikës dhe të politikave të shkollës. Vlerësimi mund të përfshijë demonstrimin e vetë-iniciativës në projekte grupore dhe individuale. Metodat e vlerësimit duhet të lehtësojnë të menduarit kritik ashtu siç një mësimdhënës lehtëson të mësuarit kreativ dhe funksional gjatë orëve të rregullta mësimore.

## 7. Referencat

2015. Performance Standards and Competencies  
([http://www.sde.ct.gov/sde/lib/sde/PDF/DEPS/Career/perf\\_stand\\_comp.pdf](http://www.sde.ct.gov/sde/lib/sde/PDF/DEPS/Career/perf_stand_comp.pdf)) .

Abernethy A.P., Etheredge L.M., Ganz P.A., Wallace P, German R.R., Neti C., (2010) Rapid-learning system for cancer care. *Journal Clinical Oncology*. 20;28(27):4268-4274

Adler. R., (2011) Osteoporosis in men: insights for a clinician. *Therapy Advances Musculoskeletal*. 3(4) 191-200;

Ammons R., (1956) Effects of knowledge of performance: a survey and tentative theoretical formulation. *Journal General Psychology* 54:279.

Archambault P.M., Bilodeau A, Gagnon M.P., Aubin K, Lavoie A, Lapointe J, Poitras J, Croteau S, Pham-Dinh M, Légaré F., (2012) Health care professionals' beliefs about using wiki-based reminders to promote best practices in trauma care. *Journal Medicine Internet Research*. 14(2):49;

Barrows, H.S., (2000). *Problem-based learning applied to medical education*. Springfield, IL: Southern Illinois University School of Medicine.

Bell, S., (2010). *Project-based learning for the 21st century: Skills for the future*. The Clearing House, 83, 39-43.

Bennett, S., & Bennett, J. W., (2000). The process of evidence-based practice in occupational therapy: Informing clinical decisions. *Australian Occupational Therapy Journal*, 47(4), 171-180.

Bocalini D.S., Serra A.J., dos Santos L et al., (2009): Strength training preserves the bone mineral density of postmenopausal women without hormone replacement therapy. *Journal of Aging Health*. 21: 519–27;

Boelens, R., Van Laer, S., De Wever, B., & Elen, J., (2015). *Blended learning in adult education: towards a definition of blended learning*. Retrieved from <https://biblio.ugent.be/publication/6905076>

Bovaird T., (2007) Beyond Engagement and Participation: User and Community Coproduction of Public Services Public Administration Review Volume 67, Issue 5 Faqe 846–860 <http://onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1111/j.1540-6210.2007.00773.x/full> .

Bovill, C., (2014). An investigation of co-created curricula within higher education in the UK, Ireland and the USA. *Innovations in Education and Teaching International*. 51 (1) 15-25

Bradley P., (2006) The history of simulation in medical education and possible future directions. *Medical Education*. 40:254-62.

Centre for Education and Learning. (2016). *Re-inventing Research-Based Teaching and Learning*.

Challis, D., von Abendorff, R., Brown, P., Chesterman, J., Hughes, J., (2002) Care management, dementia care and specialist mental health services: an evaluation, *International Journal of Geriatric Psychiatry*, 17, 4: 315-325.

Coelho C, Moles D., (2015) Student perceptions of a spiral curriculum. *European Journal Dental Education*. 20:161-6

Martins e Silva J., (2013) Educação médica e profissionalismo. *Acta Médica Portuguesa*. 26:420-7

Colley, K., (2008). Project-based science instruction: A primer. *Science Teacher*, 75(8), 23-28.

Cox, E., Bachkirova, T., Clutterbuck, D., (2010). *The complete handbook of coaching*. London: Sage.

de Lee JC, Prez D., (1994) *Orthopaedic sports medicine*, vol 11. Saunders, Philadelphia;

Cross M., Spencer, J., & Hills, J., (2014). *Guide to Developing Simulated Interprofessional Learning Activities*, (Prill), 1–19

Díaz-Méndez M., & Gummesson E., (2012) Value co-creation and university teaching quality: Consequences for the European Higher Education Area (EHEA"), *Journal of Service Management*, Vol. 23 Issue: 4, f.571-592, <https://doi.org/10.1108/09564231211260422> .



Drake R.L., McBride J.M., Lachman N, Pawlina W., (2009) Medical education in the anatomical sciences: The winds of change continue to blow. *Anatomical Science Education*. 2:253-9;

Drake R.L., (2014) A retrospective and prospective look at medical education in the United States: Trends shaping anatomical sciences education. *Journal of Natural Products*. 224:256-60.

Dunne, E. & Zandstra, R., (2011). Students as change agents. New ways of engaging with learning and teaching in higher education. Bristol: ESCalate Higher Education Academy Subject Centre for Education / University of Exeter

Ralhan S., Bhogal P., Bhatnagar G., Young J., Green M., (2012) Effective teaching skills—how to become a better medical educator. *British Medical Journal*; 344-765

Gallagher, A.G., & O’Sullivan, G.C., (2012). Fundamentals of Surgical Simulation: Principles and Practice. *Fundamentals of Surgical Simulation: Principles and Practice*, 1–372. <https://doi.org/10.1007/978-0-85729-763-1>

Garrison, D.R., & Kanuka, H., (2004). Blended learning: uncovering its transformative potential in higher education. *The Internet and Higher Education*, 7(2), 95–105. Available online from [doi.org/10.1016/j.iheduc.2004.02.001](https://doi.org/10.1016/j.iheduc.2004.02.001)

General Medical Council. Tomorrow’s doctors. General Medical Council, 2003. (Link).

Gigantesco A & Giuliani M., (2011) Quality of life in mental health services with a focus on psychiatric rehabilitation practice. *Annali dell'Istituto superiore di sanità Istituto*. 47(4):363-372; DOI: 10.4415/ANN\_11\_04\_07

Goeree, M. S., (2011). Introduction to Simulation Methods University of Zuerich Presentation

Granado, J. V., & Riley, D., (2013). Implementation handbook for simulation and ict-based learning in training and the simbase committee. The Ministry For Health And Social Welfare Of The Regional Government Of Andalusia

Guadalupe-Grau A, Fuentes T, Guerra B, & Calbet J.A.L., (2009) Exercise and Bone Mass in Adults. *Sports Medicine*. 39 (6): 439-468;

Harden R M, Crosby J R., (2000) AMEE Education Guide No 20: The good teacher is more than a lecturer—the twelve roles of the teacher. *Medical Teacher*. 22:334-47.

Harvard University. 1-minute paper worksheet: a thinking-centered self-assessment tool.(Link) .

Harries M, Williams C, Stanish W. D, Micheli L.J., (eds) (1994) Oxford textbook of sports medicine. Oxford Medical Press, Oxford

Herbert G, Townsend J, Ryan J, Wright D, Ferguson B & Wistow, G., (2000). Rehabilitation Pathways for Older People after Fractured Neck of Femur. Leeds: Nuffield Institute for Health and York Health Economics Consortium.

Hovancsek M., (2007) Using simulation in nurse education. In *Simulation in Nursing Education; from Conceptualization to Evaluation* (Jeffries P.R., ed.), National League for Nursing, New York, f. 1–9.

Irby D.M, Cooke M, O'Brien B.C., (2010) Calls for reform of medical education by the Carnegie Foundation for the Advancement of Teaching: 1910 and 2010. *Academic Medicine*. 85:220-7

Jette, D. U., Bacon, K., Batty, C., & Carlson, M., (2003). Evidence-based practice: beliefs, attitudes, knowledge, and behaviours of physical therapists. *Physical therapy*, 83(9), 786.

Klegeris, A., & Hurren, H., (2011). Impact of problem-based learning in a large classroom setting: student perception and problem-solving skills. *Advanced Psychology Dec*;35(4):408-15. doi: 10.1152/advan.00046.2011

Maudsley G., (1999) Roles and responsibilities of the problem-based learning mbikqyrës in the undergraduate medical curriculum. *British Medical Journal* 318: 657 61.<sup>[1]</sup><sub>[SEP]</sub>

Medley C.F, & Horne C., (2005) Using simulation technology for undergraduate nursing education. *Journal of Nursing Education* 44, 31–34.

Mims, B.C. et al., (2004). *Critical Care Skills: a Clinical Handbook*. (2nd ed.) Missouri: Saunders

- Moore, M., Winkelman, A., Kwong, S., Segal, S. P., Manley, G.T., Shumway, M., (2014) The emergency department social work intervention for mild traumatic brain injury (SWIFT-Acute): a pilot study, *Brain Injury*, 28, 4: 448-455.
- Mountain G., (2001) *Social Rehabilitation: Concepts, Evidence and Practice*. *Journal of Integrated Care*. 9(2). 8-15;
- Mountain G., (2011). *Social Rehabilitation: Concepts, Evidence and Practice*. *Managing Community Care*. Pavilion Publishing (Brighton) Ltd. 9:2 (8-15);
- Murgatroyd G.B., (2011) *Continuing professional development, the international perspective*. Intelligence Unit Research;
- Murray E., (2002) *Challenges in educational research*. *Medical Education* 36:110-2.
- National Qualifications Authority (NQA). (2011) *National Qualifications Framework*. Prishtina., [http://akk-ks.net/uploads/national\\_qualifications\\_framework.pdf](http://akk-ks.net/uploads/national_qualifications_framework.pdf) .
- Onyon, C., (2012). *The clinical teacher*. Blackwell Publishing Ltd. Redditch, UK
- Ratner, N. B., (2006). *Evidence-based practice: An examination of its ramifications for the practice of speech-language pathology*. *Language, Speech, and Hearing Services in Schools*, 37(4), 257-267.
- Romãozinho J.M., (1995) *The reform of medical education. Some reflections*. *Acta Médica Portuguesa*. 8:187-90
- Rotelli F, Mezzina R, De Leonardis O, Goergen R, Evaristo P, & Mezzina R., (2004) *Is rehabilitation a social enterprise. "Initiative of support to people disabled World Health Organisation - Division of Mental Health - Geneva*
- Sackett, D.L., Rosenberg, W.M., Gray, J.M., Haynes, R.B., & Richardson, W.S., (1996). *Evidence based medicine: what it is and what it isn't*. *British Medical Journal*. Jan 13;312(7023):71-2.
- Sallis R.E., Massimo F., (eds) (1997) *ACSM's essentials of sports medicine*. Mosby, London;

Seropian M.A, Brown K, Gavilanes J.S. & Driggers B., (2004) An approach to simulation program development. *Journal of Nursing Education* 43, 170–174.

Slavik M., (2008). Teaching competences. Institute of Education and Communication Presentation <https://www.slideshare.net/gueste538c3/teachers-competences>

Kopelyana S., Godonogab A. & Güneyc I., (2016). Nowreen Yasminb Assessing innovation-related competences in the MaRIHE program: Teacher and student perceptions. *Procedia - Social and Behavioral Sciences* 553 – 560.

Solomon, G., (2003). Project based learning: A primer. TechLearning, Retrieved from [http://pennstate.swsd.wikispaces.net/file/view/PBL-Primer-www\\_techlearning\\_com.pdf](http://pennstate.swsd.wikispaces.net/file/view/PBL-Primer-www_techlearning_com.pdf)

Standard for occupation/qualification profession Teacher in Health Care/ Education in Health Care, INSTEAP Project (2013-2016), a Tempus / EU funded project in Kosovo.

Sternberg. R.J., & Origorenko, E., (Eds.). (2003). *The psychology of abilities, competencies, and expertise*. New York: Cambridge University Press.

The University of Notre Dame. (2017). *Problem Based Learning Manual School of Medicine, Fremantle*. Australia: Notre Dame.

Gesundheit N., Brutlag P., Youngblood P., Gunning W.T., Zary N., & Fors U., (2009) The use of virtual patients to assess the clinical skills and reasoning of medical students: initial insights on student acceptance, *Pranuar më 17 Qërshor*, Publikuar online më: 09 Shtator. Pages 739-742

Turan, S., (2015). Simulation-based learning: how can be used to prepare teacher? *Educação, Ciência E Cultura*, 20(1), 27–43. <https://doi.org/10.18316/2236-6377.15.2>

Woodall, D., (2012) *Blended Learning Strategies: Selecting the Best Instructional Method*. Marrë ng [http://perspectives.skillsoft.com/2012/workshop\\_blended/blended\\_learning\\_strategies\\_wp.pdf](http://perspectives.skillsoft.com/2012/workshop_blended/blended_learning_strategies_wp.pdf)

Zunzarren, G.M., & Rodriguez-Sedano, A. (2011). Creating Scenarios and Guiding Learning in Medical Simulation Center. *Creative Education*, 2(3), 316–320.

<https://doi.org/10.4236/ce.2011.23044>

.